



# STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT  
DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS

## DEPËRTIMI DHE PËRDORIMI I INTERNETIT NË KOSOVË

GUSHT 2013

### Shkruar prej

Agron Fazliu  
agron@phogen.com  
www.phogen.com

### Dhënat janë mbledhur prej

Kolegji Universitar Universum  
Info@universum-ks.org  
www.universum-ks.org

### Dizajni

projectGRAPHICS

### Vërejtje

*Pikëpamjet dhe informatat e paraqitura në këtë raport i përkasin pjesëmarrësve të studimit dhe autorit; andaj nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e STIKK dhe të Kolegjit Universitar Universum.*

# PËRMBAJTJA

|                                                                             |    |
|-----------------------------------------------------------------------------|----|
| Lista e figurave .....                                                      | 4  |
| Lista e tabelave .....                                                      | 6  |
| Shkurtesat (sipas alfabetit) .....                                          | 7  |
| Fjalët kyçe .....                                                           | 7  |
| Parathënie .....                                                            | 8  |
| Përmbledhje .....                                                           | 9  |
| 1 Hyrje .....                                                               | 10 |
| 2 Studimet ekzistuese .....                                                 | 10 |
| 2.1 Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit i Kosovës (ART) .....       | 12 |
| 2.2 Agjencia e Statistikave e Kosovës - Regjistrimi i popullsisë 2011 ..... | 13 |
| 3 Nevojat dhe objektivat e studimit .....                                   | 13 |
| 4 Metodologjia dhe fushëveprimi .....                                       | 14 |
| 4.1 Mostra e popullsisë së përfshirë .....                                  | 14 |
| 4.2 Pyetësi .....                                                           | 18 |
| 5 Depërtimi i internetit .....                                              | 18 |
| 5.1 Depërtimi demografik i internetit - i bazuar në përdorues .....         | 18 |
| 5.2 Depërtimi demografik i internetit - i bazuar në ekonomi familjare ..... | 23 |
| 5.3 Depërtimi gjeografik i internetit .....                                 | 25 |
| 6 Ofrimi i shërbimit të internetit .....                                    | 27 |
| 7 Përdoruesit e internetit .....                                            | 32 |
| 7.1 Përdoruesit e internetit përmes telefonave të mençur .....              | 32 |
| 7.2 Posedimi i kompjuterëve .....                                           | 37 |
| 7.3 Shprehjet e përdoruesve .....                                           | 38 |
| 7.4 Gjuha .....                                                             | 43 |
| 8 Mos-përdoruesit e internetit .....                                        | 45 |
| 9 Shfrytëzimi i internetit .....                                            | 46 |
| 9.1.1 Argëtim .....                                                         | 46 |
| 9.1.1.1 Sporti .....                                                        | 47 |
| 9.1.1.2 Lajme .....                                                         | 49 |
| 9.1.1.3 Muzika dhe filmat .....                                             | 50 |
| 9.1.1.4 Shfletimi i përgjithshëm i internetit .....                         | 51 |
| 9.1.1.5 Interneti, e-banking dhe blerja përmes internetit .....             | 52 |
| 9.1.2 Komunikimi me zë .....                                                | 53 |
| 9.1.3 Rrjetet sociale .....                                                 | 56 |
| 9.1.3.1 Twitter .....                                                       | 56 |
| 9.1.3.2 Instagrami .....                                                    | 57 |
| 9.1.3.3 Facebook .....                                                      | 57 |
| 9.1.3.4 YouTube .....                                                       | 59 |
| 9.1.4 Komunikimi me email .....                                             | 60 |
| 9.1.5 Stili i të jetuarit .....                                             | 62 |
| 9.1.6 Hulumtime dhe studime .....                                           | 63 |
| 10 Vetëdija për e-qeverisje .....                                           | 64 |
| 11 Privatësia e informatave .....                                           | 65 |
| 12 Përfundime dhe rekomandime .....                                         | 67 |
| 13 Referencat .....                                                         | 69 |

# LISTA E FIGURAVE

|                                                                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Figura 1:</b> Pjesëmarrësit sipas moshës .....                                                                   | 16 |
| <b>Figura 2:</b> Pjesëmarrësit sipas nivelit të shkollimit .....                                                    | 16 |
| <b>Figura 3:</b> Pjesëmarrësit sipas gjinisë.....                                                                   | 17 |
| <b>Figura 4:</b> Anëtarët e familjeve të pjesëmarrësve në studim.....                                               | 17 |
| <b>Figura 5:</b> Depërtimi i internetit tek përdoruesit .....                                                       | 18 |
| <b>Figura 6:</b> Përdoruesit e internetit (rurale dhe urbane).....                                                  | 19 |
| <b>Figura 7:</b> Përdoruesit e internetit sipas të ardhurave familjare.....                                         | 20 |
| <b>Figura 8:</b> Përdoruesit e internetit sipas shkallës së shkollimit.....                                         | 20 |
| <b>Figura 9:</b> Përdoruesit e internetit sipas gjinisë .....                                                       | 21 |
| <b>Figura 10:</b> Përdoruesit e internetit sipas moshës.....                                                        | 22 |
| <b>Figura 11:</b> Lokacionet e shfrytëzimit të internetit .....                                                     | 22 |
| <b>Figura 12:</b> Çmimet e shërbimeve të internetit në zonat rurale .....                                           | 23 |
| <b>Figura 13:</b> Depërtimi i internetit në bazë të ekonomive familjare.....                                        | 24 |
| <b>Figura 14:</b> Depërtimi i internetit në bazë të ekonomive familjare në zonat rurale dhe urbane .....            | 24 |
| <b>Figura 15:</b> Depërtimi gjeografik i internetit ( <a href="http://goo.gl/shHUF">http://goo.gl/shHUF</a> ) ..... | 26 |
| <b>Figura 16:</b> Ndarja e tregut e ISP-ve.....                                                                     | 27 |
| <b>Figura 17:</b> Ndarja e tregut të ISP-ve në zonat rurale .....                                                   | 28 |
| <b>Figura 18:</b> Çmimet e ISP-ve në Kosovë .....                                                                   | 28 |
| <b>Figura 19:</b> Pakot e brezit të transmetimit të ISP-ve .....                                                    | 29 |
| <b>Figura 20:</b> Sa është niveli i kënaqësisë me lidhjen në internet.....                                          | 29 |
| <b>Figura 21:</b> Përdoruesit e internetit përmes telefonave të mençur.....                                         | 32 |
| <b>Figura 22:</b> Relacioni – Punësimi dhe posedimi i telefonave të mençur.....                                     | 33 |
| <b>Figura 23:</b> Përdorimi i internetit në pajisjet mobile (sipas moshës).....                                     | 34 |
| <b>Figura 24:</b> Përdorimi i internetit në pajisjet mobile (sipas gjinisë) .....                                   | 34 |
| <b>Figura 25:</b> Lidhja me internet me telefona të mençur .....                                                    | 35 |
| <b>Figura 26:</b> Përdoruesit e telefonave të mençur – koha e kaluar brenda ditës.....                              | 35 |
| <b>Figura 27:</b> Përdoruesit e telefonave të mençur dhe anëtarët e familjes.....                                   | 36 |
| <b>Figura 28:</b> Operatorët e rrjeteve mobile – ndarja e tregut.....                                               | 36 |
| <b>Figura 29:</b> Posedimi i kompjuterëve për ekonomi familjare.....                                                | 37 |
| <b>Figura 30:</b> Përdoruesit e kompjuterëve për një pajisje kompjuterike/laptop në shtëpi.....                     | 38 |
| <b>Figura 31:</b> Shpeshtësia e përdorimit të internetit .....                                                      | 38 |
| <b>Figura 32:</b> Shpeshtësia e përdorimit të internetit sipas gjinisë .....                                        | 39 |
| <b>Figura 33:</b> Shpeshtësia e përdorimit të internetit (sipas moshës).....                                        | 39 |
| <b>Figura 34:</b> Përdormi ditor i internetit .....                                                                 | 40 |
| <b>Figura 35:</b> Përdorimi ditor i internetit sipas moshës .....                                                   | 41 |
| <b>Figura 36:</b> Përdorimi i internetit - orë në ditë .....                                                        | 42 |
| <b>Figura 37:</b> Qëllimi i përdorimit të internetit.....                                                           | 42 |
| <b>Figura 38:</b> Përdormi i internetit nga anëtarët e familjes .....                                               | 43 |
| <b>Figura 39:</b> Gjuha e përdorur nga përdoruesit e internetit.....                                                | 43 |
| <b>Figura 40:</b> Gjuha e përdorur nga përdoruesit e internetit sipas moshës .....                                  | 44 |



|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Figura 41:</b> Gjuha e përdorur për shfletim të internetit (sipas gjinisë) .....            | 44 |
| <b>Figura 42:</b> Përdorimi i internetit në të ardhmen nga jo-përdoruesit.....                 | 45 |
| <b>Figura 43:</b> Arsyet e mospërdorimit të internetit .....                                   | 45 |
| <b>Figura 44:</b> Shërbimet e internetit që përdoren në Kosovë .....                           | 46 |
| <b>Figura 45:</b> Marrëdhëniet mes punësimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve të internetit..... | 47 |
| <b>Figura 46:</b> Përdorimi për sport (video dhe lajme) sipas moshës.....                      | 48 |
| <b>Figura 47:</b> Përdorimi për sport (video dhe lajme) sipas gjinisë .....                    | 48 |
| <b>Figura 48:</b> Përdorimi i internetit për lajme sipas moshës.....                           | 49 |
| <b>Figura 49:</b> Përdorimi i internetit për lajme sipas gjinisë .....                         | 49 |
| <b>Figura 50:</b> Shkarkimi i filmave dhe muzikës (sipas moshës) .....                         | 50 |
| <b>Figura 51:</b> Shkarkimi i filmave dhe muzikës (sipas gjinisë) .....                        | 50 |
| <b>Figura 52:</b> Shfletim i përgjithshëm i internetit (sipas moshës).....                     | 51 |
| <b>Figura 53:</b> Shfletim i përgjithshëm i internetit (sipas gjinisë) .....                   | 51 |
| <b>Figura 54:</b> Besimi në blerjen përmes internetit.....                                     | 52 |
| <b>Figura 55:</b> Besimi në blerjen përmes internetit sipas moshës .....                       | 53 |
| <b>Figura 56:</b> Përdorimi i internetit për komunikim me VoIP sipas moshës .....              | 54 |
| <b>Figura 57:</b> Përdorimi i internetit për komunikim me VoIP sipas gjinisë.....              | 54 |
| <b>Figura 58:</b> Përdorimi i internetit – shërbimi i Skype (sipas moshës) .....               | 55 |
| <b>Figura 59:</b> Përdorimi i internetit – shërbimet e Skype (sipas gjinisë) .....             | 55 |
| <b>Figura 60:</b> Përdorimi i Twitter sipas moshës.....                                        | 56 |
| <b>Figura 61:</b> Përdorimi i Twitter sipas gjinisë.....                                       | 57 |
| <b>Figura 62:</b> Përdoruesit e Instagramit sipas moshës.....                                  | 57 |
| <b>Figura 63:</b> Përdorimi i Facebook sipas moshës.....                                       | 58 |
| <b>Figura 64:</b> Përdoruesit e Facebook sipas gjinisë .....                                   | 58 |
| <b>Figura 65:</b> Përdorimi i internetit - shërbimet e YouTube (sipas moshës).....             | 59 |
| <b>Figura 66:</b> Përdorimi i internetit - shërbimet e YouTube (sipas gjinisë).....            | 59 |
| <b>Figura 67:</b> Përdorimi i emailit për çështje personale sipas moshës .....                 | 60 |
| <b>Figura 68:</b> Përdorimi i emailit për çështje personale sipas gjinisë.....                 | 60 |
| <b>Figura 69:</b> Përdorimi i emailit për punë sipas moshës .....                              | 61 |
| <b>Figura 70:</b> Përdorimi i emailit për punë sipas gjinisë .....                             | 61 |
| <b>Figura 71:</b> Interneti dhe stili i të jetuarit (sipas moshës) .....                       | 62 |
| <b>Figura 72:</b> Interneti dhe stili i të jetuarit (sipas gjinisë) .....                      | 62 |
| <b>Figura 73:</b> Shfrytëzimi i internetit për hulumtime dhe studime (sipas moshës) .....      | 63 |
| <b>Figura 74:</b> Shfrytëzimi i internetit për hulumtime dhe studime (sipas gjinisë) .....     | 63 |
| <b>Figura 75:</b> Shërbimet e e-qeverisjes.....                                                | 64 |
| <b>Figura 76:</b> Shërbimet e e-qeverisjes sipas gjinisë.....                                  | 64 |
| <b>Figura 77:</b> Shërbimet e e-qeverisjes sipas moshës.....                                   | 65 |
| <b>Figura 78:</b> Vetëdijesimi për privatësinë e informatave.....                              | 66 |
| <b>Figura 79:</b> Vetëdijesimi për privatësinë e informatave (sipas gjinisë) .....             | 66 |
| <b>Figura 80:</b> Vetëdijesimi për privatësinë e informatave sipas moshës.....                 | 67 |

## LISTA E TABELAVE

|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Tabela 1:</b> Studime të ngjashme .....                                                     | 11 |
| <b>Tabela 2:</b> Depërtimi i internetit - regjistrimi i popullsisë 2011 .....                  | 13 |
| <b>Tabela 3:</b> Shpërndarja e anketës .....                                                   | 15 |
| <b>Tabela 4:</b> Përdoruesit e internetit sipas gjinisë .....                                  | 21 |
| <b>Tabela 5:</b> Depërtimi gjeografik i internetit .....                                       | 25 |
| <b>Tabela 6:</b> Çmimet e ISP-ve në nivel shtetëror .....                                      | 31 |
| <b>Tabela 7:</b> Korrelacioni midis përdoruesve mobil të internetit dhe të të punësuarve ..... | 32 |

# SHKURTESAT (sipas alfabetit)

BE – Bashkimi Evropian  
ccTLD – Kodi kryesor i domenit shtetëror  
CIA- Agjencia Qendrore Amerikane e Inteligjencës  
GPS – Sistemi i pozitës globale  
ISO – Organizata Ndërkombëtare për Standardizim  
ISP – Ofrues i Shërbimit të Internetit  
ITU – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit  
LAN – Rrjeti Lokal Kompjuterik  
PC – Kompjuter Personal  
PoP – Pika e pranisë  
RIPE NCC - The Réseaux IP Européens Network Coordination Centre  
RSSI – Treguesi i fuqisë së sinjalit të pranuar  
SSID – Identifikuesi i shërbimit  
STIKK - Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit e Kosovës  
TIK – Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit  
ART – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit i Kosovës  
UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim  
VoIP – Protokolli i transmetimit të zërit në internet

## FJALËT KYÇE

*Depërtimi i internetit, telefonat e mençur, Kosova, ofruesit e shërbimeve të internetit, përdorimi i internetit, internet pa tel, përdorues, mashkull, femër, ekonomi familjare, urbane, rurale, mostër e rastësishme e stratifikuar dhe proporcionale, facebook, twitter, youtube, instagram, email, shqiptar, anketë, kërkimi mobil i pikave të internetit pa tel, rrjetet sociale, aspekte demografike, regjistrimi i popullsisë.*

# PARATHËNIE

Me krenari ju prezantojmë raportin për Depërtimin dhe Përdorimin e Internetit në Kosovë, i dyti në vazhden e raporteve të matjes së perceptimit të qytetarëve sa i përket problemeve dhe sfidave në lidhje me qasjen në Internet, raport ky i cili mbulon nevojat e ndryshme dhe boshllëqet në të dhënat që kanë të bëjnë me mbështetjen e biznesit si dhe infrastrukturën dhe shërbimet e Internetit.

Ky raport përfaqëson zërat e 1050 kosovarëve nga 30 komuna, të cilët ndajnë mendimet e tyre lidhur me atë se sa gëzojnë qasje adekuate në internet dhe sa janë të kënaqur me shërbimet e ofruara. Për më tepër, ky studim synon të kuptojë me mirë sjelljet dhe qëndrimet në Internet. Të kuptojmë se si përdoruesit, veçanërisht të rinjtë, e shfrytëzojnë internetin ka një rëndësi të madhe në fuqizimin e mëtejshëm të brezave të rinj në Kosovë në shfrytëzimin e TIK si një mjet.

Kapitulli i parë i raportit paraqet analizën e studimeve ekzistuese lidhur me këtë çështje që nga viti 2000 e tutje, duke përdorur të dhënat nga Autoriteti i Telekomunikacionit të Kosovës dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe lokale.

Ndërsa pjesa tjetër e raportit paraqet depërtimin demografik të internetit (ekonomitë familjare dhe përdoruesit), depërtimin gjeografik të Internetit dhe përdorimin e internetit (sjelljen e përdoruesve).

Ne jemi të bindur se numri i mjaftueshëm i të dhënave dhe analiza e realizuar lidhur me depërtimin dhe përdorimin e Internetit në Kosovë do të stimulojë pjesëmarrje dhe diskutime kuptimplota të cilat do të ndihmojnë qeveritë lokale dhe qendrore të zbatojnë veprime për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e shërbimeve publike në komunat e tyre, duke kontribuar për një jetë më të mirë për të gjithë popullin e Kosovës. Për më tepër, ky raport do të mundësojë pozicionimin e Kosovës në Agjendën globale të TIK dhe do të hapë dyert për mundësitë e investimeve të mundshme.

Ne shprehim mirënjohjen tonë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për kontributin e tyre të vlefshëm përmbajtësor dhe atë financiar në përgatitjen e raportit.

Ju dëshirojmë lexim të këndshëm!

**Vjollca Çavolli**

Drejtoresha Ekzekutive STIKK

# PËRMBLEDHJE

Me shfrytëzimin e metodave të hulumtimit dhe analizimit të dokumenteve, të një qasje kuantitative dhe të metodave të tjera, studimi në fjalë synon të pasurojë hulumtimin<sup>1</sup> e mëparshëm të natyrës së njëjtë, me ç'rast rifreskohen të dhënat përkitazi me depërtimin dhe përdorimin e internetit në Kosovë. Gjatë këtij hulumtimi janë studiuar shprehinë dhe përdorimi i internetit, si dhe depërtimi i tij nga aspekti demografik, duke u bazuar në ekonomitë familjare dhe përdoruesit e internetit. Përveç kësaj, janë mbledhur dhe paraqitur të dhëna sa i përket depërtimit të internetit nga aspekti gjeografik. Të gjeturat tregojnë se lidhjen me internet dhe të mirat e tij i shfrytëzojnë si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Kështu, studimi tregon se depërtimi i internetit në Kosovë është në një shkallë të kënaqshme dhe se mund të krahasohet me vendet e zhvilluara. Depërtimi i internetit në bazë të ekonomive familjare është 84.8%. Depërtimi i internetit në bazë të përdoruesve është 76.6%, dhe se depërtimi i internetit nga aspekti gjeografik tregon se në rrugët rajonale janë mesatarisht 9 rrjete të internetit pa tel për në një kilometër. Ekzistojnë arsye të ndryshme për këtë shkallë të lartë të depërtimit të internetit. Arsyeja kryesore është mosha mesatare shumë e re e popullsisë në Kosovë, e cila dëshiron t'i ndjek trendet globale, si dhe popullsia e Kosovës që jeton jashtë shtetit dhe vazhdon të mbajë lidhje me familjet dhe me miqtë në Kosovë.

Sipas të gjeturave të këtij studimi shumica e shprehive të përdoruesve të internetit janë të krahasueshme me trendet globale. Rrjetet sociale dhe shërbimet e komunikimit me zë përmes internetit shfrytëzohen kryesisht prej femrave, dhe se ky është gjithashtu një trend global. Kosovarët janë më aktivë në facebook sesa në rrjetet e tjera, që është një prej kanaleve kryesore për të arritur tek një numër sa më i madh i përdoruesve. Pa marrë parasysh statusin e punësimit dhe të ardhurat familjare, kosovarët janë një shoqëri e lidhur me internet në një shkallë të ngjashme me vendet e zhvilluara.

Studimi gjithashtu vjen në përfundim se do të ketë një ngadalësim të depërtimit të mëtejshëm të internetit në Kosovë për shkak të arritjes së pjekurisë së këtij tregu. Kjo është ajo periudhë kohore kur institucionet e Kosovës, kompanitë dhe organizatat e tjera do të kenë nevojë që ta përmirësojnë edhe më tej cilësinë e përgjithshme të shërbimeve, të qeverisjes elektronike, të kontrollit prindëror, të rregullimit të tregut, dhe në përgjithësi të shoqërisë së informacionit. Studimi ofron informata shtesë që mund t'i ndihmojnë autoritetet, sektorin privat, organizatat ndërkombëtare, investuesit e mundshëm që të hartojnë rregullore dhe të marrin vendime në bazë të analizave të ofruara. Në fund, raporti sugjeron që institucionet e Kosovës mbase do të donin të shqyrtonin themelimin e Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit.

1 [http://www.stikk-ks.org/images/stories/publikime/STIKK-raport\\_eng\\_email.pdf](http://www.stikk-ks.org/images/stories/publikime/STIKK-raport_eng_email.pdf)

# 1. HYRJE

Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), një shoqatë e TIK-ut me seli në Prishtinë, është e angazhuar për përmirësimin e sektorit të TIK-ut në Kosovë. Ky studim u bë i mundur falë përkrahjes së tyre.

Sa i përket kësaj fushe, aktualisht në Kosovë të dhënat dhe analiza e tyre bëhet kryesisht në nivelin qendror. Informatat dhe burimet e të dhënave, të cilat janë publike, janë krijuar duke përdorur burime kryesisht prej ofruesve të shërbimeve të internetit ose prej burimeve dytësore. Siç shpjegohet më poshtë, kjo qasje nuk ka dëshmuar të jetë metoda më e saktë për shkak të ndryshimeve të shpejta që ndodhin në treg, të gabimeve të ofrimit të informacionit, dhe mungesës së shkëmbimit të informatave midis palëve të interesit, si dhe të vështirësive në përmbledhjen e të dhënave me qëllim të analizimit të tyre në kontekst nacional/kombëtar.

Ekzistojnë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të TIK-ut në Kosovë. Si rrjedhojë, STIKK e ka kontraktuar botimin e dytë vjetor të këtij raporti me qëllim të ofrimit të informatave në temën e depërtimit dhe përdorimit të internetit, duke përfshirë analiza dhe rekomandime. Phogen LLC është kontraktuar për t'i mbledhur të dhënat nga aspekti digjital, për t'i përpunuar, analizuar dhe interpretuar ato. Procesi i mbledhjes së të dhënave në terren është bërë nga Kolegji Universitar Universum, i cili e ka krijuar një ekip prej 30 hulumtuesve të terrenit (studentë universitarë) të udhëhequr nga një profesor universitar, i cili është ekspert i kësaj fushe.

## 2. STUDIMET EKZISTUESE

Tema e depërtimit të internetit në Kosovë është hulumtuar nga kompani dhe organizata të ndryshme. Ekziston një sasi e konsiderueshme e informatave nga burime dytësore si *statistikat botërore të internetit*<sup>2</sup>. Gjithashtu, ekzistojnë edhe raporte në internet të cilat sugjerojnë se nuk ka pasur rritje të internetit në Kosovë prej vitit 2000<sup>3</sup>. Tabela më poshtë ofron informata të detajuara sa i përket burimeve të ndryshme në këtë fushë:

2 <http://www.Internetworldstats.com/europa2.htm#kv>

3 [http://ptgmedia.pearsoncmg.com/images/9780789747884/supplements/9780789747884\\_appC.pdf](http://ptgmedia.pearsoncmg.com/images/9780789747884/supplements/9780789747884_appC.pdf), p. 9.



| Nr | Titulli                                                                             | Depërtimi i internetit sipas përdoruesve | Ref. faqe      | Muaji/viti   |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|----------------|--------------|
| 1  | EU Kosovo Progress Report 2009 <sup>4</sup>                                         | 5.40%                                    | 41             | 2008         |
| 2  | eSEE ICT Status Report - Stability Pact <sup>5</sup>                                | 6%                                       | 95             | Prill 2004   |
| 3  | Cullen Report IV (Enlargement countries telecommunications monitoring) <sup>6</sup> | 6.24%                                    | 136            | Janar 2010   |
| 4  | EU Kosovo Progress Report 2010 <sup>7</sup>                                         | 6.40%                                    | 28             | 2009         |
| 5  | Pasqyrë e tregut të telekomunikacionit: TM3/4-2012 <sup>8</sup>                     | 8.72%                                    | 45             | 2012         |
| 6  | Investing in Kosovo 2009 <sup>9</sup>                                               | 12%                                      | 16             | 2005         |
| 7  | National Background Report on ICT Research for Kosovo (2009) <sup>10</sup>          | 20%                                      | 24             | Nëntor 2009  |
| 8  | Investing in Kosovo 2010 <sup>11</sup>                                              | 20.90%                                   | 19             | Shtator 2009 |
| 9  | Households with Internet Connection <sup>12</sup>                                   | 53%*                                     | Faqja kryesore | 2009         |
| 10 | Internet penetration and usage in Kosovo                                            | 72.1%*                                   | 20             | Mars 2012    |
| 11 | Kosovo Census 2011 <sup>13</sup>                                                    | 57.1%*                                   | 118            | 2011         |
| 12 | UNDP - Kosovo Mosaic 2012 <sup>14</sup>                                             | 62%*                                     | 29             | Shkurt 2012  |

**Tabela 1: Studime të ngjashme**

***\*) Depërtimi i internetit në ekonomi familjare***

4 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/ks\\_rapport\\_2009\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf)

5 [www.stabilitypact.org/e-see/040906-ict-status.pdf](http://www.stabilitypact.org/e-see/040906-ict-status.pdf)

6 <http://www.cullen-international.com/ressource/224/0/final-study-report-31-march-2011.pdf>

7 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

8 [www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4\\_2012.pdf](http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf)

9 [www.eciks.org/english/publications/investing\\_in\\_kosovo/content/media/investorsguide\\_web.pdf](http://www.eciks.org/english/publications/investing_in_kosovo/content/media/investorsguide_web.pdf)

10 [www.wbc-inco.net/attach/KosovoICTReportFINAL\\_01\\_12\\_2009.pdf](http://www.wbc-inco.net/attach/KosovoICTReportFINAL_01_12_2009.pdf)

11 [http://ambasada-ks.net/us/repository/docs/Attach\\_1\\_Investing\\_in\\_Kosovo\\_2010.pdf](http://ambasada-ks.net/us/repository/docs/Attach_1_Investing_in_Kosovo_2010.pdf)

12 <http://www.indexkosova.com>

13 [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results\\_ENG.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results_ENG.pdf)

14 [www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mosaic/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Eng\\_735317.pdf](http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mosaic/Kosovo_Mosaic_2012_Eng_735317.pdf)

## 2.1 AUTORITETI RREGULLATIV I TELEKOMUNIKACIONIT I KOSOVËS (ART)

Autoriteti Rregullativ i Kosovës (ART) mbledh rregullisht informata sa i përket depërtimit të internetit prej ofruesve të shërbimeve të internetit përmes një pyetësori<sup>15</sup>, të cilin e plotësojnë çdo tre muaj. ART-ja është burimi zyrtar i informatave për gjendjen e telekomunikacionit në Kosovë (duke përfshirë edhe depërtimin e internetit), si dhe shërben si burimi kryesor i informatave në këtë sektor për kompani dhe institucione të ndryshme globale dhe rajonale (duke përfshirë ITU-n në të ardhmen); si rrjedhojë është kushtuar më shumë vëmendje.

Hulumtimi i mëparshëm i sponsorizuar nga STIKK (2012) doli në përfundim se nuk janë publikuar të dhënat e ndara për komunë, edhe pse kjo kërkohet në pyetësorët e dhënë nga ART-ja. Sipas tremujorit të katërt (TM4) 2012, ART-ja ka filluar ta publikojë një listë (pa ndarjen e të dhënave në zona rurale e urbane) të depërtimit të internetit në bazë të komunave<sup>16</sup>.

Sipas raportit të ART-së, TM3 2012, depërtimi i internetit është 8.72% (shih fig. 56 në raportin e ART-së). Duket se ka dallime në mes të publikimeve të ndryshme hulumtuese dhe botimeve të ART-së, por janë duke u bërë konsultime me qëllim që të kuptohen metodologjitë dhe qasjet e përdorura nga ART-ja. Me qëllim që të ofrohet sa më shumë qartësi, ART-ja mund t'i ketë parasysh këto elemente:

1. Rishikimi i metodologjisë së mbledhjes dhe analizimit të të dhënave
2. Shënimi i burimit të të dhënave
3. Përcaktimi i përdorimit të definicioneve në mënyrë konsistente
4. Ndarja e të dhënave në zonat rurale dhe urbane në nivel komunal

Njëra ndër arsytet të cilat qëndrojnë prapa këtyre sugjerimeve ndërlidhet me Synimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara (UN- United Nations, MDG- Millenium Development Goals) indikator 8-16 (përdoruesit e internetit për 100 banorë) e cila është e zhvilluar me ITU dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Tashmë një numri i madh i shteteve janë duke u bërë matjet lidhur me depërtimin e internetit përmes hulumtimeve, me ç'rast edhe STIKK e ka parë të arsyeshme përdorimin e të njëjtës metodologji. Dallimet në rezultate mund të shfaqen për shkak se raporti i ART llogarit depërtimin e internetit në bazë të shfrytëzuesve/ përdoruesve duke e ndarë numrin e parapaguesve me numrin e përgjithshëm të popullatës, të përshkruar në përqindje. Megjithatë, Raporti i Vlerësimit i Cullen International mbi Kosovën<sup>17</sup> cek se kjo llogaritje tregon vetëm depërtimin e rrjetës broadband dhe jo depërtimin e internetit në bazë të shfrytëzuesve sikurse se citohet më poshtë:

“Depërtimi i rrjetit broadband i definuar si numri i parapaguesve me qasje me shpejtësi prej 144k/bit apo më tepër si përqindje e popullsisë.”

Më tepër, përkritazi me metodologjinë e shfrytëzuar nga ART, UN MDG thekson si në vijim<sup>18</sup>: “Një numër i madh i shteteve janë duke u bërë matjet e përqindjes së individëve të cilët janë duke shfrytëzuar internetin përmes hulumtimeve të bëra me ekonomitë familjare.... Aty ku nuk ka pasur mundësi të realizimit të pyetësorëve, një mesatare e përqindjes së individëve të cilët e përdorin internetin mund të nxirret në bazë të numrit të indikatorëve sikurse parapagimet broadband fikse (me tel), parapagimet e telefonisë fikse, parapagimet broadband aktive përmes telefonave mobil dhe të ardhurat e shtetit.

Përderisa të dhënat lidhur me përqindjen e individëve të cilët e shfrytëzojnë internetin janë shumë të besueshme për shtetet të cilat kanë realizuar pyetësorët zyrtar me ekonomitë familjare, këto janë me pak të besueshme në rastet kur numri i shfrytëzuesve të internetit vlerësohet në bazë të numrit të parapagimeve të internetit.

Ndarja për këtë indikator, duke përfshirë moshën dhe gjininë është e mundur në shtetet ku të dhënat rrjedhin nga pyetësorët e realizuara me ekonomitë familjare. Ky është rasti tek një numër në rritje i shteteve në zhvillim e sipër.

Metodologjia e përdorur për të krijim e mesatares së përqindjes së individëve të cilët e përdorin internetin duhet që gjithëmonë të përshkruhet me rastin e paraqitjes së të dhënave.”

15 [http://art-ks.org/repository/docs/Pyetesori%20per%20Sherbimet%20e%20Internetit\\_\(ISP\).xls](http://art-ks.org/repository/docs/Pyetesori%20per%20Sherbimet%20e%20Internetit_(ISP).xls)

16 [www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4\\_2012.pdf](http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf)

17 <http://www.ebrd.com/downloads/legal/telecomms/kosovo.pdf>

18 <http://mdgs.un.org/unsd/mi/wiki/8-16-Internet-users-per-100-inhabitants.ashx>

Duke i marrë parasysh aspiratat e Kosovës për Integritim Evropian, anëtarësim në KB dhe ITU, si vet faktin se depërtimi i internetit është i krahasueshëm me shtetet e zhvilluara, e marrim paragrafin e dytë të cituar si një bazë për sugjerime, ku ART-ja do të ishte mirë të përcjellë trendet më të reja lidhur me metodologjitë e adoptuara globalisht për grumbullimin e indikatorëve, duke përfshirë depërtimin e internetit..

## 2.2 AGJENCIA E STATISTIKAVE E KOSOVËS – REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011

Rishtas, Kosova e ka kryer procesin e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 dhe se në të janë përfshirë edhe dy pyetje sa i përket depërtimit të internetit në ekonomitë familjare dhe të posedimit të kompjuterëve<sup>19</sup>. Këto rezultate<sup>20</sup> janë përpunuar dhe janë paraqitur në vijim:

| Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011          | Urbane        | Rurale        | Totali        |
|--------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|
| Ekonomi familjare                                | 127886        | 168649        | 296535*       |
| Ekonomi familjare me qasje në internet           | 89311         | 80007         | 169318        |
| Depërtimi i internetit sipas ekonomive familjare | <b>69.84%</b> | <b>47.44%</b> | <b>57.10%</b> |

**Tabela 2: Depërtimi i internetit – regjistrimi i popullsisë 2011**

*\*) Shih tabelën e publikimit, f. 118*

Hulumtimet e mëparshme të sponsorizuara nga STIKK mbulonin 28 zona urbane (qytete) dhe 49 zona rurale (fshatra). Rezultatet tregonin se depërtimi i internetit sipas ekonomive familjare ishte 72.1%. Pasi shumica e intervistave ishin bërë në zonat urbane, ky rezultat është i përafërt me rezultatin e regjistrimit të popullsisë për depërtimin e internetit në zonat urbane sipas ekonomive familjare, e që është 69.84%.

Është me rëndësi të ceket se mungesa e publikimit të tabelave të unifikuara me të dhëna të ndara sipas grupmoshës, gjinisë dhe aspektit rural e urban e bëjnë përlogaritjet më të komplikuar për nevojat e analizave të ndryshme.

## 3. NEVOJAT DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Objektivi kryesor i këtij studimi është ofrimi i një pasqyre të depërtimit dhe të përdorimit të internetit në Kosovë (i cili është kryer në qershor të vitit 2013). Përveç kësaj, qëllimi i studimit është mbulimi i nevojave të ndryshme dhe të zbrazëtirës që ekziston në të dhëna sa i përket mbështetjes afariste dhe të infrastrukturës e shërbimeve të internetit. Në bazë të të dhënave në dispozicion, duket e qartë se ekziston një nevojë e madhe për studime të detajuara dhe të herëpashershme, të cilat do të trajtonin probleme relevante, do ta mbështetnin biznesin, si dhe do t'i tërhiqnin kompanitë e huaja investuese, të cilat do ta bënin zgjidhjen e tyre afariste duke u bazuar në informatat e ofruar. Gjithashtu, krijimi i një tregu konkurrues me shërbime më transparente është parakusht për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të internetit, dhe ofron një vlerë më të mirë për parat e paguara; po ashtu duhet të bëhet një monitorim më i mirë i këtij sektori që mund të arrihet përmes aplikimit të rregulloreve më efikase nga qeveria (p.sh. cilësia e shërbimeve të ISP-ve), pastaj të kryhen hulumtime në një fushë specifike me interes, të shfrytëzohen mjetet/burimet ekzistuese në mënyrë optimale, si dhe të zbatohen praktikatat më të mira.

Ky studim po ashtu synon ta kuptojë më mirë qëndrimin dhe shprehjet e përdoruesve ndaj internetit. Është me rëndësi tejet të madhe të kuptuarit se si e shfrytëzojnë përdoruesit internetin, e në veçanti të rinjtë me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të gjeneratave të reja të Kosovës në shfrytëzimin e TIK-ut si një instrument<sup>21</sup>. Ky

<sup>19</sup> <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/R2ENG.pdf>

<sup>20</sup> [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results\\_ENG.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results_ENG.pdf), p. 118, 204

<sup>21</sup> [http://www.stikk-ks.org/sq/component/dms/doc\\_download/9-skills-gap-analysis-for-information-and-communication-technology+skillsgap+analysis+STIKK](http://www.stikk-ks.org/sq/component/dms/doc_download/9-skills-gap-analysis-for-information-and-communication-technology+skillsgap+analysis+STIKK)

studim gjithashtu synon krijimin e një baze studimore, e cila monitorohet dhe analizohet edhe më tej me fokus se si shkathtësitë për TIK të të rinjve kosovarë mund të përmirësohen dhe zhvillohen përmes aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme si qendrat inovative, trajnimet specifike, praktikat, çertifikimet, vizitat studimore, etj.

Faza e hulumtimit të dokumenteve nxori në pah se nuk është e identifikuar sa duhet infrastruktura e internetit në Kosovë. Kompanitë që veprojnë në Kosovë janë të kufizuara për shkak të shkëmbimit të informatave dhe të bashkërendimit me palët e tjera relevante. Si rrjedhojë, kjo mënyrë nuk ofron një hartë të saktë të identifikimit të infrastrukturës së përbashkët të internetit dhe, si rezultat, është penguar bashkëpunimi ndërsektorial. Për ta ilustruar këtë mund t'i marrim për shembull kompanitë e ndërtimit, të cilat për shkak të mungesës së informatave dhe kontrollit të rreptë nga autoritetet lokale, mund ta prishin infrastrukturën e internetit gjatë kryerjes së punimeve (siç ndodh mjaft shpesh me kabllo të energjisë elektrike dhe gypave të ujit).

Infrastruktura e internetit është me rëndësi të veçantë për proceset afariste dhe zhvillimore të një vendi. Një shembull të cilin ia vlen ta përmendim është Zelanda e Re, e cila kishte sukses në krijimin e një harte kombëtare të internetit që shërben “për ta identifikuar të gjithë rrjetin e internetit të Zelandës së Re dhe për të ofruar informata e mjete ndihmëse për planifikim infrastrukturor, si dhe të dhëna përmbledhëse.”<sup>22</sup> Gjatë këtij procesi është vërejtur një praktikë e mirë ku furnizuesit e rrjetit përreth Zelandës së Re ia kanë ofruar vullnetarisht Komisionit Shtetëror të Shërbimeve hartën e mbulimit të tyre me rrjet<sup>23</sup>.

## 4. METODOLOGJIA DHE FUSHËVEPRIMI

Mbledhja e të dhënave për këtë studim ka filluar së pari me hulumtimin e dokumenteve në zyrë. Gjatë kësaj faze u morën parasysh burimet dytësore për këtë studim, duke e shfrytëzuar literaturën dhe njohuritë ekzistuese. Të dhënat demografike, të ndara në bazë të gjinisë, moshës dhe lokacionit, janë marrë nga burimet e regjistrimit të popullsisë në Kosovë<sup>24</sup> të organizuara nga Zyra e Regjistrimit të Popullsisë.

Mbledhja e të dhënave përmes anketës është kryer përmes një qasje kuantitative. Përmes pyetësorit elektronik të Phogen-it në kompjuterë tabletë, të dhënat janë mbledhur gjatë periudhës prej 11 deri më 22 qershor 2013. Fushëveprimi i këtij studimi përfshinë depërtimin demografik të internetit (ekonomi familjare dhe përdorues), depërtimin gjeografik dhe shfrytëzimin e internetit (shprehitë e përdoruesve). Përveç kompjuterëve personal dhe laptopëve si pajisje për t'u qasur në internet, në këtë studim janë përfshirë edhe telefonat e mençur (të përkufizuar si telefona mobil me mundësi të qasjes në internet).

### 4.1 MOSTRA E POPULLSISË SË PËRFSHIRË

Mostra e popullsisë së përfshirë në studim u stratifikua përmes shfrytëzimit të metodologjisë së *mostrës së rastësishme proporcionale të stratifikuar*. Në fillim është analizuar popullsia e tërësishme e grupuar sipas gjinisë dhe e ndarë në bazë të zonave (rurale dhe urbane). Këto të dhëna u stratifikuan në bazë të grupmohave. Në fund, është përkufizuar numri i pyetësorëve për secilën komunë (urbane dhe rurale), grupmoshë dhe gjini. Popullsia nën moshën 10 vjeçare është përjashtuar për shkak të natyrës së pyetjeve dhe marrjes së miratimit nga prindërit e tyre. Si rrjedhojë, popullsia për qëllim të hulumtimit ishte rreth 1.4 milion (1,409,604) që e mbulonte afërsisht 77.64% të popullsisë së Kosovës prej gjithsej 1,815,606<sup>25</sup>. Hapi i fundit ishte përfshirja e aspektit proporcional të metodologjisë. Numri i përgjithshëm i pyetësorëve (1050) u nda sipas shtresave të grupmoshës, gjinisë dhe zonës (urbane e rurale). U nxorën rezultatet e mëposhtme në lidhje me nivelin dhe intervalin e *besueshmërisë*<sup>26</sup>:

a) Niveli i besueshmërisë 95%

b) Intervali i besueshmërisë 3%

Me fjalë të tjera, nëse metodologjia e njëjtë e anketës (me mostrën e njëjtë të popullsisë) do të aplikohet sërish, me 95% të besueshmërisë, rezultatet do të ishin plus/minus 3% të rezultateve aktuale. Vëreni se në këtë punim do të përllogaritet niveli më i ulët i intervalit të besueshmërisë.

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e shpërndarjes së rezultateve përfundimtare:

<sup>22</sup> <http://www.broadbandmap.govt.nz/>

<sup>23</sup> Ibid.

<sup>24</sup> <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,40,265>

<sup>25</sup> <http://esk.rks-gov.net/eng/>

<sup>26</sup> <http://www.macorr.com/sample-size-methodology.htm>

| Nr        | Komuna        | Urbane | Rurale | Gjithsej |
|-----------|---------------|--------|--------|----------|
| 1         | Deçan         | 2      | 25     | 27       |
| 2         | Gjakovë       | 24     | 34     | 58       |
| 3         | Glllogoc      | 15     | 23     | 38       |
| 4         | Gjilan        | 40     | 26     | 66       |
| 5         | Dragash       | 1      | 31     | 32       |
| 6         | Istog         | 6      | 20     | 26       |
| 7         | Kaçanik       | 9      | 17     | 26       |
| 8         | Klinë         | 1      | 21     | 22       |
| 9         | Fushë Kosovë  | 11     | 10     | 21       |
| 10        | Kamenicë      | 5      | 17     | 22       |
| 11        | Mitrovicë     | 32     | 22     | 54       |
| 12        | Lipjan        | 5      | 29     | 34       |
| 13        | Novobërdë     | 1      | 16     | 17       |
| 14        | Obiliq        | 3      | 8      | 11       |
| 15        | Rahovec       | 11     | 25     | 36       |
| 16        | Pejë          | 27     | 28     | 55       |
| 17        | Podujevë      | 15     | 33     | 48       |
| 18        | Prishtina     | 97     | 26     | 123      |
| 19        | Prizren       | 57     | 21     | 78       |
| 20        | Skenderaj     | 8      | 18     | 26       |
| 21        | Shtime        | 3      | 14     | 17       |
| 22        | Suharekë      | 8      | 31     | 39       |
| 23        | Ferizaj       | 24     | 38     | 62       |
| 24        | Viti          | 1      | 26     | 27       |
| 25        | Vushtrri      | 18     | 26     | 44       |
| 26        | Malishevë     | 2      | 30     | 32       |
| 27        | Junik         | 1      | 1      | 2        |
| 28        | Mamushë       | 0      | 1      | 1        |
| 29        | Hani i Elezit | 0      | 5      | 5        |
| 30        | Klllokot      | 1      | 0      | 1        |
| Gjithsej: |               | 428    | 622    | 1050     |

Tabela 3: Shpërndarja e anketës

Diagramet më poshtë ofrojnë më shumë informata lidhur me pjesëmarrësit, të cilët janë përgjigjur në pyetësonin elektronik, dhe të cilët nuk janë patjetër shfrytëzues ose mos shfrytëzues të internetit. Duket se shumica e pjesëmarrësve në studim i takojnë grupmoshës 10-30 vjeçare, duke qenë grupmosha më e madhe në Kosovë për shkak se, siç ceket edhe në uebfaqen e CIA-s,<sup>27</sup> mosha mesatare në Kosovë është 27.4 vjeçe.

### Pjesëmarrësit sipas moshës




Figura 1: Pjesëmarrësit sipas moshës

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë nxënës që e kanë kryer shkollën e mesme, kurse 2.76% nuk kishin ndonjë shkollim formal.

### Pjesëmarrësit sipas nivelit të shkollimit




Figura 2: Pjesëmarrësit sipas nivelit të shkollimit

Diagrami më poshtë i paraqet pjesëmarrësit në bazë të gjinisë. Vëreni se në bazë të regjistrimit të popullsisë 2011, norma mes meshkujve dhe femrave është 101.32 / 100.

### Pjesëmarrësit sipas gjinisë




Figura 3: Pjesëmarrësit sipas gjinisë

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 janë mesatarisht 5.85 anëtarë të një familje që jetojnë në një shtëpi. Kjo përkon me diagramin më poshtë ku shumica e pjesëmarrësve në studim jetojnë nëpër shtëpi prej 5-6 anëtarësh në familje.

### Anëtarët e familjeve të pjesëmarrësve në studim




Figura 4: Anëtarët e familjeve të pjesëmarrësve në studim

## 4.2 PYETËSORI

Pyetësi është përpiluar duke i shfrytëzuar udhëzimet<sup>28</sup> për përpilimin e pyetësorëve. Pyetësi i ka pasur gjithsej 39 pyetje, duke përfshirë edhe disa pyetje që kishin të bënin me informatat personale të pjesëmarrësve (mosha, gjinia, vendbanimi). Ky pyetësi ka pasur edhe pyetje me shumë opsione, ndërsa asnjë pyetje të tipit të hapur. Po ashtu, pyetësi ishte i ndarë në seksione që kishin të bënin me informata demografike, përdorues të internetit dhe mos-përdorues të internetit. Prej 1050 pyetësorëve 59.2% ishin të shpërndarë në zona rurale dhe 40.8% në zona urbane. Intervistat u kryen me kontakt të drejtpërdrejt, pra në prani fizike, duke bërë një përzgjedhje të pjesëmarrësve në mënyrë të rastësishme brenda një shtrese/grupi të caktuar. Meqë u përdor pyetësi elektronik, si rrjedhojë janë shfrytëzuar edhe disa veçori të tij. Pra, janë aplikuar plotësisht veçori të tilla si logjika e kapërcimit të pyetjeve, kontrolli i zgjedhjes së përgjigjeve me shumë opsione, si dhe teknika të tjera të vlefshmërisë.

## 5. DEPËRTIMI I INTERNETIT

Ekzistojnë dy lloje të depërtimit të internetit, depërtimi gjeografik i internetit, dhe depërtimi demografik i internetit (ekonomitë familjare dhe përdoruesit). Të dhënat e mbledhura sa i përket depërtimit mund të bëhen me anë të shumë metodave dhe qasjeve. Depërtimi gjeografik i internetit nënkupton, në përgjithësi, një hartë të detajuar gjeografike që i identifikon mediumet të cilat e bartin trafikun e internetit nëpër ekonomi familjare. Depërtim demografik i internetit bazohet në ekonomi familjare dhe përdorues individualë. Kjo e mëparshmja del prej përqindjes së nxjerrë prej numrit të përgjithshëm të ekonomive familjare që kanë lidhje interneti, ndërsa tjetra del prej numrit të përdoruesve të internetit nga numri i përgjithshëm i popullsisë.

### 5.1 DEPËRTIMI DEMOGRAFIK I INTERNETIT - I BAZUAR NË PËRDORUES

Diagrami më poshtë e tregon depërtimin e internetit tek përdoruesit, duke e pasur parasysh edhe shpeshësinë e shfrytëzimit të internetit. Përdoruesit të cilët e përdorin internetin njëherë në muaj ose më pak (1%) u përjashtuan nga analizat, ndërsa u përfshinë në këto analiza përdoruesit që e përdorin internetin dy herë në javë ose më shumë, e deri te ata që e përdorin çdo ditë. Përveç kësaj, është marrë parasysh edhe shkalla e ulët e

#### Depërtimi i internetit tek përdoruesit




Figura 5: Depërtimi i internetit tek përdoruesit



intervalit të besueshmërisë prej 3%. Andaj, depërtimi i internetit në bazë të përdoruesve është **së paku 76.62%** ose 1,080,038 përdorues të internetit (në bazë të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 2011).

Në fakt, kjo shifër paraqet një shkallë të madhe të depërtimit të internetit. Megjithatë, në vendet e zhvilluara, depërtimi i internetit në vitin 2013 vlerësohet të jetë 77%, sipas raportit të botuar të ITU-s<sup>29</sup>. Një faktor tjetër që e shpjegon më tej shkallën e depërtimit të internetit në Kosovë është tregu i parregulluar i ofrimit të shërbimeve të internetit. Për shembull, kemi një situatë tipike ku një person në fshat blen lidhje të internetit pa tel (pasi shumica e popullsisë pjesëmarrëse, siç e përmendëm më lartë, jeton në zonat rurale) nga një prej ofruesve të mëdhenj të internetit, dhe pastaj ua shet atë shtëpive të tjera në fshat. Ky model është i parregulluar dhe jashtë kontrollit të autoriteteve. Megjithatë, është një mënyrë efektive e sigurimit të qasjes më të gjerë të internetit nga popullsia lokale. Në bazë të raporteve të ART-së, ofrues të tjerë të internetit të paspecifikuar u shërbejnë po thuaj 10412<sup>30</sup> përdoruesve. Fakti tjetër, jo më pak i rëndësishëm, është diaspora<sup>31</sup> e Kosovës, e cila dëshiron të mbajë lidhje me familjet e tyre në Kosovë, dhe si rrjedhojë u ofrojnë kompjuterë dhe mbase i mbulojnë edhe shpenzimet e lidhjes me internet për ta. Në këtë kontekst, raporti Mozaiku 2012 i UNDP-së thekson se “25 për qind e ekonomive familjare raportojnë mbështetje në remitenca, një shifër që është edhe më e lartë tek ekonomitë familjare në zonat rurale dhe aty ku kreu i familjes është femër.”<sup>32</sup>

Rezultatet e depërtimit të internetit tek përdoruesit në zonat rurale dhe urbane janë interesante për shkak se një numër i lartë i përdoruesve të internetit jetojnë në zonat rurale, siç paraqitet në diagramin më poshtë. Mund të kenë ndikuar disa faktorë në këtë fakt, siç janë: shumica e kosovarëve jetojnë në zonat rurale, numri mesatar i anëtarëve të familjes në një ekonomi familjare (shtëpi) rurale është më i lartë sesa i atyre në zonat urbane (banesa), nevoja e mbajtjes së lidhjeve me anëtarët e familjes që jetojnë jashtë vendit (pasi shumica e diasporës kosovare vijnë nga zonat rurale), etj. Ngjashëm me depërtimin e përgjithshëm të internetit tek përdoruesit është konsideruar edhe përdorimi i rastësishëm i internetit (një herë në muaj ose më pak) si dhe niveli më i ulët i intervalit të besueshmërisë (3%).

### Përdoruesit e internetit sipas zonave rurale dhe urbane




Figura 6: Përdoruesit e internetit (rurale dhe urbane)

Ekziston një marrëdhënie midis depërtimit të internetit, shkollimit dhe të ardhurave siç e nxjerr si përfundim një botim<sup>33</sup>, i cili e përshkruan një model që mundëson vlerësimin e shkallës së depërtimit të internetit sipas të ardhurave dhe shkallës së shkollimit. Në Kosovë, pyetja për të ardhurat familjare/personale është ndër përgjigjet më të rralla të dhëna tek jo-përdoruesit e internetit, siç e shohim më poshtë (shih figurën 42).

29 <http://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures2013.pdf>

30 [www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4\\_2012.pdf](http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf)

31 [www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/ressources/resource\\_en\\_180366.pdf](http://www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/ressources/resource_en_180366.pdf)

32 [www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/ourwork/povertyreduction/successstories/how-to-become-a-driving-force--kosovo-diaspora/](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/ourwork/povertyreduction/successstories/how-to-become-a-driving-force--kosovo-diaspora/)

33 [http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2145704](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2145704)

### Përdoruesit e internetit sipas të ardhurave familjare Urbane




Figura 7: Përdoruesit e internetit sipas të ardhurave familjare

### Përdoruesit e internetit sipas nivelit të shkollimit




Figura 8: Përdoruesit e internetit sipas shkallës së shkollimit

Rezultatet e përdoruesve të internetit në bazë të shkallës së shkollimit janë të ngjashme me rezultatet e përgjithshme të pjesëmarrësve, arsyeja kryesore për këtë është se një pjesë e madhe e pjesëmarrësve janë përdorues të internetit.

## Përdoruesit e internetit sipas gjinisë




Figura 9: Përdoruesit e internetit sipas gjinisë


Diagrami më lartë tregon përdorimin e internetit sipas gjinisë, ku prej të gjithë meshkujve pjesëmarrës në studim 81% janë përdorues të internetit, ndërsa 19% nuk janë përdorues. Ngjashëm, 80% të femrave pjesëmarrëse në studim janë përdoruese të internetit, ndërsa 20% nuk janë përdoruese. Këto shifra nuk duhet të krahasohen me depërtimin e gjithëmbarshtëm të internetit tek përdoruesit pa i marrë parasysh edhe faktorët e përmendur më lartë. Në krahasim me vendet e tjera, sipas botimeve të ITU-s<sup>34</sup>, shifrat e Kosovës janë të ngjashme me ato të vendeve të zhvilluara, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Vëreni se të dhënat nuk janë mbledhur brenda vitit të njëjtë - të dhënat nga Kosova janë mbledhur 4 vjet më vonë në krahasim me vendet e tjera në këtë tabelë.

| Vendi                | Meshkuj | Femra | Viti | Burimi |
|----------------------|---------|-------|------|--------|
| Kosova               | 81.4    | 79.8  | 2013 | STIKK  |
| Turqia               | 50.1    | 29.9  | 2010 | ITU    |
| Serbia               | 47.3    | 36.3  | 2009 | ITU    |
| Kroacia              | 55.4    | 46.1  | 2009 | ITU    |
| Bullgaria            | 47      | 43.1  | 2009 | ITU    |
| Maqedonia            | 54      | 49.5  | 2009 | ITU    |
| Greqia               | 49.2    | 40    | 2009 | ITU    |
| Gjermania            | 83.2    | 75.3  | 2009 | ITU    |
| Zvicra               | 88.6    | 79.4  | 2010 | ITU    |
| Mbretëria e Bashkuar | 84.5    | 81.2  | 2009 | ITU    |

Tabela 4: Përdoruesit e internetit sipas gjinisë

34 <http://www.itu.int/ITU-D/ict/statistics/Gender>

## Përdoruesit e internetit sipas moshës




**Figura 10: Përdoruesit e internetit sipas moshës**

Diagrami në lidhje me përdoruesit sipas moshës tregon qartë se kosovarët janë përdorues të rinj të internetit dhe se shumica e tyre janë nën moshën 30 vjeçare.

Përdorimi i internetit prej shtëpive doli të jetë 94.21% (kjo shifër nuk e paraqet depërtimin e internetit nëpër ekonomi familjare), ndërsa të intervistuarit po ashtu janë shprehur se e përdorin internetin edhe në vende të tjera, si në punë (26.6%), në shtëpi të shokëve (12.17%), në shkollë/universitete (12.41%), dhe në internet kafe (8.16%). Vëreni se internet kafet janë përkufizuar si dyqane ku ofrohet internet në bazë të orëve të kaluara në kompjuterë të lidhur me internet dhe të cilët e kanë këtë veprimtari primare për biznesin e tyre. Këtë po e themi për ta sqaruar dallimin me shfrytëzimin e internetit pa tel nëpër hotele, bare, kafene që ofrohet fal në të gjitha qytetet e Kosovës.

## Lokacioni i shfrytëzimit të internetit nga përdoruesit në studim



**Figura 11: Lokacionet e shfrytëzimit të internetit**

Ekzistojnë dallime sa i përket çmimit për njësi të kapacitetit të transmetimit (1Mbps) të cilën e paguajnë abonentët, ku fshatrat bartin një kosto më të lartë. Po ashtu, ekzistojnë dallime sa i përket teknologjive që përdoren, siç ceket edhe në studimet e mëparshme të bëra nga STIKK në vitin 2012, ku shumica e zonave rurale lidhen përmes teknologjive të internetit pa tel, ndërsa zonat urbane lidhen kryesisht me rrjet kabllor. Tema e çmimit analizohet më në detaje bashkë me ofrimin e shërbimeve të internetit (shih më poshtë).

### Çmimet e shërbimeve të internetit në zonat rurale




Figura 12: Çmimet e shërbimeve të internetit në zonat rurale

## 5.2 DEPËRTIMI DEMOGRAFIK I INTERNETIT – I BAZUAR NË EKONOMI FAMILJARE

Sa i përket depërtimit të internetit në bazë të ekonomive familjare, diagrami i dhënë më poshtë jep më shumë detaje. Sa i përket intervalit të ulët të besueshmërisë, edhe përmbledhja e përgjigjeve “po” tregon se depërtimi i internetit në ekonomi familjare është **së paku 84.81%** ose 251,962 ekonomi familjare (në bazë të ekonomive familjare sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 2011). Në këtë kontekst, Bashkimi Evropian e ka botuar një raport ku thuhet se 84% e ekonomive familjare në vendet e zhvilluara kanë lidhje të internetit<sup>35</sup>. Vlen të përmendet se UNDP-ja e ka botuar raportin *Mozaiku i Kosovës 2012* (të dhënat e mbledhura në shkurt të vitit 2012), dhe se depërtimi i internetit në bazë të ekonomive familjare, për shembull në Prishtinë është 82%, i pasuar nga Mitrovica me 76%<sup>36</sup>.

35 [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/ebs/ebs\\_362\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/ebs/ebs_362_en.pdf)

36 [www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Eng\\_735317.pdf](http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Eng_735317.pdf)

### A keni qasje në internet në shtëpinë ose banesën tuaj?




Figura 13: Depërtimi i internetit në bazë të ekonomive familjare

Depërtimi i internetit në ekonomi familjare në zonat rurale është së paku 87%, që është pak më e lartë se në zonat rurale që është së paku 83%. Kjo është diçka e pritshme për shkak se zonat urbane përbëhen kryesisht prej objekteve banesore, ku mesatarja e numrit të anëtarëve të familjes është me e ulët, ndërsa në zonat rurale popullsia jeton nëpër shtëpi (me probabilitet më të lartë të përdoruesve të internetit). Si rrjedhojë, kemi numër më të vogël të ekonomive familjare me qasje në internet në zonat rurale, ndërsa numri i përdoruesve është më i madh. Arsyeja e dytë është se shumica (61%) e popullsisë jeton në zonat rurale.

### Depërtimi i internetit sipas ekonomive familjare në zonat rurale dhe urbane




Figura 14: Depërtimi i internetit në bazë të ekonomive familjare në zonat rurale dhe urbane

## 5.3 DEPËRTIMI GJEOGRAFIK I INTERNETIT

Për ta analizuar më tej shkallën e depërtimit të internetit nga pikëpamja gjeografike është bërë një kërkim<sup>37</sup> i pikave të internetit dhe i regjistrimit të lokacioneve me GPS nëpër rrugë rajonale të përzgjedhura rastësisht. Sipas uebfaqes së CIA-s, në bazë të dhënave të vitit 2009, Kosova i ka 1,964 km rrjet rrugor, të cilat përfshijnë gjatësinë e rrugëve të asfaltuara dhe të paasfaltuara<sup>38</sup>. Vëreni se janë marrë vetëm informatat publike si SSID, protokolli i autentifikimit, kanali dhe detajet RSSI (shih hartën ndërvepruese për më shumë detaje).

| Nr        | Prej      | Përmes           | Deri          | Rrjetet e internetit pa tel | Distanca (km) |
|-----------|-----------|------------------|---------------|-----------------------------|---------------|
| 1         | Prishtinë | -                | Gjilan        | 389                         | 42            |
| 2         | Prishtinë | -                | Podujevë      | 232                         | 26            |
| 3         | Prishtinë | -                | Mitrovicë     | 468                         | 33            |
| 4         | Prishtinë | -                | Pejë          | 917                         | 78            |
| 5         | Gjakovë   | Deçan            | Pejë          | 175                         | 35            |
| 6         | Prishtinë | Ferizaj          | Hani i Elezit | 582                         | 60            |
| 7         | Glllogoc  | Skenderaj        | Klinë         | 371                         | 55            |
| 8         | Lipjan    | Shtime, Suhareke | Prizren       | 560                         | 53            |
| 9         | Prizren   | -                | Gjurgjicë     | 190                         | 48            |
| Gjithsej: |           |                  |               | 3884                        | 430           |

VËREJTJE: Nuk janë regjistruar rrjetet e internetit pa tel brenda këtyre qyteteve

**Tabela 5: Depërtimi gjeografik i internetit**

Siç shihet në hartën në vijim, densiteti i rrjeteve rritet më afër qyteteve më të mëdha, ndërsa ekziston një prani konstante e pikave të qasjes mes qyteteve, duke e konfirmuar shkallën më të lartë të depërtimit të internetit në zonat rurale. Rregullat konvencionale të emërimit të pikave të qasjes të regjistruara të internetit pa tel e bëjnë të mundur identifikimin e ofruesve të shërbimit të internetit. Shumica e ofruesve të shërbimeve të internetit i kanë pajisjet e tyre të para-konfiguruar, dhe si rrjedhojë emri i tyre paraqitet në shumë pika të qasjes. Po ashtu, një pjesë e pikave të qasjes ishin pronë e vet ofruesve të shërbimeve të internetit. Ky fakt ishte i dukshëm shpeshherë në emrin e pikave të qasjes së internetit pa tel, i cili e përfshinte emrin e ofruesit të shërbimit të internetit, e madje edhe numrin e telefonit, mbase për ndihmë ndaj konsumatorit. Sipas të dhënave të mbledhura, ekzistojnë 9 rrjete të internetit pa tel për një kilometër në rrugët rajonale të Kosovës. Vëreni se ekzistojnë edhe faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në këtë përafri, si faktori i densitetit të popullsisë, kodrat, liqenet (vëreni liqeni i Badovcit kah Gjilani, ku nuk ka pika të qasjes në internet), etj. Mund t'i qaseni një harte në Google për t'i analizuar të dhënat sa i përket këtyre rrjeteve të internetit pa tel<sup>39</sup> (shih vjegëzën më poshtë).

37 <http://dspace.cusat.ac.in/jspui/handle/123456789/2362>

38 <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/rankorder/2085rank.html>

39 <http://goo.gl/shHUF>



Figura 15: Depërtimi gjeografik i internetit (<http://goo.gl/shHUF>)



## 6. OFRIMI I SHËRBIMIT TË INTERNETIT

Sipas raportit tremujor<sup>40</sup> të publikuar nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, ekzistojnë 51 kompani të licencuara (një rritje prej 14 ofruesve të shërbimit të internetit që janë licencuar, në bazë të TM3 2011) që ofrojnë shërbime të internetit për konsumatorë, dhe 5 (një ofrues më pak i shërbimit të internetit, prej TM3 2011) kompani të licencuara për shkëmbin ndërkombëtar të trafikut të internetit. 46 ofruesit e tjerët të shërbimeve të internetit kanë qasje në internet përmes pesë ofruesve kryesorë të licencuar të shërbimeve të internetit. Përveç kësaj, përmes procesit të kërimit të pikave të qasjes nëpër rrugët rajonale të cilin e përmendëm më herët është vërejtur se ekzistojnë ISP rajonale dhe rurale që funksionojnë por nuk janë të renditur si të tilla në raportet e ART-së. Është praktikë e mirë që të përfshihen më shumë detaje sa i përket ISP-ve të renditura dhe të parenditura në këto raporte. Po ashtu, edhe ISP-të e regjistruar RIPE mund të gjenden lehtë në bazën e RIPE NCC<sup>41</sup>.

Diagrami më poshtë e paraqet ndarjen e tregut të ofruesve kryesorë të shërbimeve të internetit (urbane dhe rurale), por në të përfshihen edhe ofruesit e tjerë lokal të shërbimeve të internetit që kapin 33% të tregut të përgjithshëm. Vëreni se opsioni 'ofruesit e tjerë të shërbimeve të internetit' përbëhet prej të gjithë ofruesve të tjerë të shërbimeve të internetit që mund të bëjnë furnizimin me lidhje në internet përmes ofruesve kryesorë; andaj, nuk kemi detaje përfundimtare të ndarjes së tregut të ofruesve të shërbimeve të internetit. Përveç kësaj, edhe ofruesit e tjerë më të vegjël të shërbimeve të internetit që kanë lidhje ndërkombëtare janë përfshirë në këtë grup.

### Cila kompani ju ofron shërbime të internetit?




Figura 16: Ndarja e tregut e ISP-ve

Në bazë të të dhënave të mbledhura dhe, siç shihet në diagramin në vijim, 44.5% e zonave rurale janë të mbuluara nga ofruesit e shërbimit të internetit (pa qasje të drejtpërdrejtë në internet, por përmes një prej ofruesve kryesor të shërbimeve të internetit). Pjesa tjetër prej 55.5% mbulohet nga ofruesit kryesorë të shërbimeve të internetit. Për transparencë, ART-ja dhe ISP-të kryesore mund ta marrin parasysh shkëmbimin e informatave me ART-në sa i përket ISP-ve të tyre më të vegjël/lokalë, ndërsa këta ISP-të do t'i dorëzonin edhe shënimet që kanë të bëjnë me ofruesit e tjerë. Kjo qasje do të garantonte një pasqyrë më të qartë të ndarjes së tregut në shkallë vendi.

40 [www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4\\_2012.pdf](http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf)

41 <https://apps.db.ripe.net/search/full-text.html>

## Ofruesit e shërbimit të internetit në zonat rurale




Figura 17: Ndarja e tregut të ISP-ve në zonat rurale

Sa i përket çmimit të shërbimeve të internetit, diagrami më poshtë ofron më shumë informata. Ia vlen të përmendet se vetëm 7% e popullsisë nuk e dinin çmimin për pakon e shërbimeve të internetit që i paguajnë. Megjithatë, kur u pyetën sa i përket brezit të shërbimeve që e paguajnë, përqindja e pjesëmarrësve të cilët nuk e dinin atë ishte 40.7%. Këto shifra tregojnë mungesën e vetëdijes mes popullatës në raport me shërbimin dhe brezin e transmetimit të internetit për të cilin paguajnë.

## Sa paguani në muaj për internet (dhe TV nëse së bashku)?




Figura 18: Çmimet e ISP-ve në Kosovë

### Çfarë kapaciteti të internetit keni në shtëpi?




Figura 19: Pakot e brezit të transmetimit të ISP-ve

Diagrami më poshtë e paraqet atë se sa janë të kënaqur abonentët me kapacitetin e brezit të ofruar të internetit. Është me rëndësi ta kemi parasysh proporcionin e përdoruesve (8%) të cilët janë të kënaqur me shpejtësinë e internetit vetëm herët në mëngjes dhe vonë në mbrëmje. Kjo çështje lidhet me koeficientin e kërkesës maksimale ndaj një brezi të internetit<sup>42</sup> dhe me numrin e përdoruesve që lidhen me të njëjtën pikë të shkëmbimit/internetit pa tel (PoP).

### A jeni të kënaqur me shpejtësinë e internetit në shtëpi?




Figura 20: Sa është niveli i kënaqësisë me lidhjen në internet

42 <http://www.broadbandwatchdog.co.uk/contention.php>

Duke e pasur parasysh faktin se Autoriteti Rregullativ i Kosovës i mbledh çdo tre muaj informatat nga ofruesit e shërbimeve të internetit, atëherë shtimi i këtij koeficienti të dhënash do të ishte i dobishëm<sup>43</sup>, edhe pse shumica e përdoruesve janë të lumtur me shpejtësinë e tyre të internetit. Me qëllim të ilustrimit të çështjes së koeficientit të kërkesës maksimale në brezin e internetit e kemi sjellë më poshtë një paragraf të cituar nga Autoriteti Rregullativ i Telekomit të Indisë:

*“Të gjithë ofruesit e shërbimeve do të ofrojnë informata sa i përket koeficientit të kërkesës maksimale në brez të internetit, i cili aplikohet nga ta me qëllim të ofrimit të shërbimeve të internetit në planet e tyre të trafikut që i dorëzohen ART-së së Indisë, në doracakun e praktikës, në qendrat e thirrjes dhe uebsajtet e tyre.*

*Të gjithë ofruesit e shërbimeve (ISP-të, UASL-të, CMSP-të, BSO-të) do ta publikojnë çdo tre muaj koeficientin e kërkesës maksimale në brezin e internetit për shërbimet e ndryshme të internetit në uebfaqet e tyre me qëllim që t’u ndihmohet abonentëve të marrin vendime të informuara.”<sup>44</sup>*

Tabela më poshtë i paraqet çmimet e ofruesve të shërbimit të internetit. Aty paraqiten po ashtu informata të detajuara sa i përket brezit të internetit, shpejtësisë maksimale, etj. Vëreni se shumica e ISP-ve e reklamojnë brezin e pandryshuar të rrjetit të internetit, e jo shpejtësinë maksimale. Në bazë të vlerave të reklamuar nënkuptohet se klienti do ta ketë të garantuar shpejtësinë e reklamuar në çdo kohë. Kjo është një situatë e ngjashme me atë në Indi (2009, ku autoriteti mbikëqyrës i telefonisë duhej të merrte masa adekuate, duke theksuar se “shpejtësia në dispozicion e brezit të rrjetit është më e ulët sesa shpejtësia e abonuar”<sup>45</sup>.

43 [http://berec.europa.eu/doc/berec/bor\\_10\\_46.pdf](http://berec.europa.eu/doc/berec/bor_10_46.pdf)

44 [http://www.trai.gov.in/WriteReadData/UserFiles/Documents/AnnualReports/ar\\_08\\_09.pdf](http://www.trai.gov.in/WriteReadData/UserFiles/Documents/AnnualReports/ar_08_09.pdf)

45 <http://www.trai.gov.in/WriteReaddata/ConsultationPaper/Document/cpaper15jan09.pdf>

| ISP            | Pakoja        | Çmimi mujor (TVSH-ja e përfshirë) | Kanalet televizive | Kapaciteti i shkarkimit të brezit (Mbps)               | Kufizimi i transferimit (GB) | Burimi             |
|----------------|---------------|-----------------------------------|--------------------|--------------------------------------------------------|------------------------------|--------------------|
| IPKO           | TV + Internet | 19.95 €                           | 64                 | Deri në 10                                             | Pa kufizim                   | www.ipko.com       |
|                | TV + Internet | 32.95 €                           | 98                 | Deri në 10                                             | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 44.95 €                           | -                  | Deri në 80                                             | 200                          |                    |
|                | Internet      | 9.95 €                            | -                  | Deri në 10                                             | 10                           |                    |
|                | Internet      | 14.95 €                           | -                  | Deri në 10                                             | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 19.95 €                           | -                  | Deri në 15                                             | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 29.95 €                           | -                  | Deri në 30                                             | 120                          |                    |
| Kujtesa        | TV + Internet | 18.00 €                           | n/a                | 5                                                      | Pa kufizim                   | www.kujtesa.com    |
|                | TV + Internet | 21.00 €                           | n/a                | 20                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | TV + Internet | 29.00 €                           | n/a                | 40                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | TV + Internet | 39.00 €                           | n/a                | 60                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 8.00 €                            | -                  | 2                                                      | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 13.00 €                           | -                  | 10                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 19.00 €                           | -                  | 20                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 29.00 €                           | -                  | 40                                                     | Pa kufizim                   |                    |
| PTK (Telekomi) | Internet      | 8.99 €                            | -                  | 2                                                      | Pa kufizim                   | www.telekomi.net   |
|                | Internet      | 13.99 €                           | -                  | 4                                                      | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 17.99 €                           | -                  | 8                                                      | Pa kufizim                   |                    |
| ArtMotion      | TV + Internet | 15.00 €                           | 70 - 80            | 20                                                     | Pa kufizim                   | www.artmotion.info |
|                | Internet      | 7.99 €                            | -                  | 10                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 11.00 €                           | -                  | 15                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 15.00 €                           | -                  | 25                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                | Internet      | 30.00 €                           | -                  | 50                                                     | Pa kufizim                   |                    |
|                |               |                                   |                    | Data e nxjerrjes së këtyre të dhënave: 12 qershor 2013 |                              |                    |

**Tabela 6: Çmimet e ISP-ve në nivel shtetëror**

Në fund, ia vlen të përmendet se Kosova është një rajon me konkurrencë të lartë sa i përket linjave ndërkombëtare me qira. Kështu, Cullen International, në raportin e tyre të vitit 2013 thekson se “Për 2 Mbps të gjysmë qarkut me një vend të afërt ...Kosova i ka çmimet më të ulëta, të cilat janë ulur edhe më tej prej muajit mars të vitit 2012 me 32%, një nivel prej €7,200 në vit.”<sup>46</sup>

46 <http://www.cullen-international.com/ressource/5127/0/report-3-april-2013-final.pdf>

## 7. PËRDORUESIT E INTERNETIT

### 7.1 PËRDORUESIT E INTERNETIT PËRMES TELEFONAVE TË MENÇUR

Tema e re që nuk paraqitet në hulumtimet e mëparshme të sponsorizuara nga STIKK është lidhja e përdoruesve me internet përmes telefonave të mençur. Siç është përshkruar më lart, telefona të mençur konsiderohen të gjithë telefonat mobil që kanë aftësi të lidhen me internet. Diagrami më poshtë e paraqet përqindjen e përdoruesve të internetit që kanë qasje në internet përmes telefonave të tyre mobil.

#### A keni qasje në internet prej telefonit tuaj mobil?




Figura 21: Përdoruesit e internetit përmes telefonave të mençur


Lidhja mes punësimit dhe posedimit të telefonave të mençur është mjaft interesante. Në Kosovë, të papunësuarit kanë më shumë telefona të mençur në posedim sesa popullsia e punësuar. Përveç faktit se papunësia është 35.1%<sup>47</sup>, faktori tjetër që duket të ketë ndikim në këtë çështje interesante ka të bëjë me anëtarët e familjes që jetojnë jashtë Kosovës, të cilët vazhdojnë t'u dërgojnë të afërmve në Kosovë telefona të mençur. Mundësia tjetër është se të punësuarit kosovarë u blejnë telefona të mençur anëtarëve të papunësuar të familjeve të tyre, të afërmve ose miqve. Për ta përforcuar edhe më tej këtë është aplikuar korrelacioni i Pearson-it dhe t-testet, të cilat janë paraqitur në vijim:

|                                  |                           | Përdoruesit mobil të internetit | Të punësuar? |
|----------------------------------|---------------------------|---------------------------------|--------------|
| Përdoruesit mobil të internetit? | Korrelacioni i Pearson-it | 1                               | -.030        |
|                                  | Sig. (2- kahesh )         |                                 | .404         |
|                                  | N                         | 775                             | 763          |
| Të punësuar?                     | Korrelacioni i Pearson-it | -.030                           | 1            |
|                                  | Sig. (2-kahesh)           | .404                            |              |
|                                  | N                         | 763                             | 978          |

Tabela 7: Korrelacioni midis përdoruesve mobil të internetit dhe të të punësuarve

Siç mund të shihet në tabelën më lartë, rëndësia (vlera p e testit 2-kahesh) është më e vogël se 0.5, andaj nuk ka ndonjë korrelacion me rëndësi statistikore mes dy variabëlve (të përdorimit mobil të internetit dhe të të punësuarve). Me fjalë të tjera, rritja ose zvogëlimi në njëri variabël (p.sh. punësimi) nuk lidhet dukshëm me rritjen ose zvogëlimin e variablit të dytë. Gjithashtu me një rëndësi më të madhe është edhe vlera p që është afër me 0, që nënkupton se ka një marrëdhënie të dobët mes këtyre dy variabëlve; si rrjedhojë, ndryshimet në njëri variabël nuk janë të lidhura me ndryshimet në variablin e dytë. Në përgjithësi, kjo nënkupton se edhe nëse punësohen më shumë njerëz prapë se prapë nuk do të ketë një relacion mes kësaj dukurie dhe posedimit të më shumë, ose më pak, telefonave të mençur në Kosovë. Prandaj, pa marrë parasysh gjendjen e punësimit, kosovarët janë të lidhur me internet, siç janë të lidhura edhe rajonet e tjera përreth dhe më gjerë në Evropë. Shifrat aktuale janë dhënë në diagramin më poshtë:

### Statusi i punësimit i përdoruesve mobil të internetit



**Figura 22: Relacioni – Punësimi dhe posedimi i telefonave të mençur**

Diagrami më poshtë e paraqet përdorimin e internetit në telefonat mobil sipas grupmoshës dhe gjinisë. Duket qartë fakti se përdoruesit më të mëdhenj mobil të internetit janë grupmosha 10-29 vjeçare, dhe se numri i meshkujve është paksa më i lartë. Për ta ilustruar këtë, diagrami më poshtë tregon se 72% e pjesëmarrësve të moshës 20-29 vjeçare e shfrytëzojnë internetin në telefonat e tyre të mençur, ndërsa 28% e tyre nuk i shfrytëzojnë aftësitë lidhëse në internet përmes telefonave të tyre të mençur.

### Përdorimi i internetit në pajisje mobile (sipas moshës)




Figura 23: Përdorimi i internetit në pajisjet mobile (sipas moshës)

### Përdorimi i internetit në pajisje mobile sipas gjinisë




Figura 24: Përdorimi i internetit në pajisjet mobile (sipas gjinisë)

Diagrami më poshtë nxjerr në pah një çështje interesante. Edhe pse operatorët më të mëdhenj të rrjetit mobil ofrojnë shërbime GPRS, vetëm 16% e shfrytëzojnë këtë teknologji. Njëra prej arsyeve kryesore për këtë ka të bëjë me mbulimin e gjerë të rrjetit të internetit pa tel në Kosovë. Vëreni se vetëm një përqindje e vogël e pronarëve të telefonave të mençur nuk janë në dijeni për këto mundësi.



### Si lidheni në internet përmes telefonit tuaj mobil




Figura 25: Lidhja me internet me telefona të mençur

Në diagramin më poshtë mund të vërehet se pjesa më e madhe e përdoruesve të telefonave të mençur duket se e kalojnë një orë në ditë në internet përmes pajisjeve të tyre mobile, në krahasim me Mbretërinë e Bashkuar ku mesatarisht përdoruesit i kalojnë 2 orë në ditë<sup>48</sup>. Në anën tjetër, 36.5% e kosovarëve i kalojnë më shumë se 3 orë në internet përmes pajisjet të tyre mobile.

### Sa orë në ditë e përdorni internetin prej telefonit tuaj?




Figura 26: Përdoruesit e telefonave të mençur - koha e kaluar brenda ditës

48 <http://www.dailymail.co.uk/sciencetech/article-2333261/We-spend-MORE-time-phones-partner.h>

Sa i përket anëtarëve të familjeve të pjesëmarrësve në studim duket se shumica e përdoruesve të telefonave të mençur i kanë edhe dy anëtarë të tjerë të familjes që posedojnë telefona të mençur.

#### Sa anëtarë të tjerë të familjes e shfrytëzojnë internetin prej telefonave të tyre?




Figura 27: Përdoruesit e telefonave të mençur dhe anëtarët e familjes

Diagrami më poshtë nuk ka të bëjë me telefonat e mençur për shkak se thjesht merret me përdoruesit e telefonave mobil dhe shërbimet përkatëse të operatorëve të rrjetit mobil. Është e mundur që grupi 'operatorët e tjerë' të paraqes pjesëmarrësit në studim të cilët ose kanë shërbime roaming ose klientët e operatorëve të vendeve fqinje.

#### Nëse keni numër të telefonit, kush është operatori i rrjetit tuaj mobil?




Figura 28: Operatorët e rrjeteve mobile - ndarja e tregut

## 7.2 POSEDIMI I KOMPJUTERËVE

Të dhënat tregojnë se aktualisht 52% e ekonomive familjare të pjesëmarrësve në studim janë të pajisur me një kompjuter tavoline ose laptop. Është me rëndësi të ceket fakti se 37% e ekonomive familjare kanë në posedim një kompjuter të dytë, dhe se gati 9% e tyre e kanë edhe një kompjuter të tretë. Vëreni se posedimi i kompjuterëve në Kosovë është më i ulët se në vendet evropiane, ku përqindja është 68%. Megjithatë, Kosova ka shifra të krahasueshme me vendet e tjera të rajonit, si Rumania (53%), Hungaria (54), dhe Greqia (55%)<sup>49</sup>. Është me rëndësi ta përmendim se raporti i UNDP-së, Mozaiku i Kosovës, thekson se 87.5%<sup>50</sup> e ekonomive familjare në Prishtinë e posedojnë një kompjuter.

### Sa kompjuterë dhe/ose laptopë i keni në shtëpi?




Figura 29: Posedimi i kompjuterëve për ekonomi familjare

Nëse ky informacion krahasohet me diagramin në vijim bëhet e qartë se pjesa më e madhe e familjeve janë në atë situatë ku 3 përdorues e përdorin kompjuterin e njëjtë. Andaj, është e qartë se nevojiten më shumë kompjuterë për ekonomi familjare/shtëpi me qëllim të përmbushjes së standardit një kompjuter për një përdorues në shtëpi. Një prej çështjeve që mund të ngrihet është se pse kosovarët e kanë më të lehtë të gjejnë burime për blerjen e telefonave të mençur sesa të kompjuterëve personalë. Përgjigja mund të lidhet me transportin më të lehtë të telefonave të mençur në krahasim me kompjuterët personal (monitorët dhe shtëpizat).

49 [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/ebs/ebs\\_362\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/ebs/ebs_362_en.pdf)

50 [www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Eng\\_735317.pdf](http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Eng_735317.pdf)

### Përfshirë ju, sa anëtarë të tjerë të familjes e përdorni kompjuterin e njëjtë?




Figura 30: Përdoruesit e kompjuterëve për një pajisje kompjuterike/laptop në shtëpi

## 7.3 SHPREHITË E PËRDORUESVE

Kosovarët janë përdorues seriozë të internetit, siç paraqitet në diagramin më poshtë. Përqindja e përdoruesve që e përdorin internetin njëherë në muaj ose më pak nuk janë marrë parasysh si përdorues të internetit. Në këtë kontekst, EuroStat-i ([isoc\_ci\_ifp\_fu]) thekson se 84% e qytetarëve evropian e shfrytëzojnë internetin për çdo ditë. Është me rëndësi të përmendim se Kosova e ka një popullsi shumë më të re në krahasim me vendet e BE-së, dhe se interneti ka qenë gjithnjë tërheqës për gjeneratat më të reja.

### Shpeshtësia e përdorimit të internetit




Figura 31: Shpeshtësia e përdorimit të internetit

### Shpeshtësia e përdorimit të internetit (sipas gjinisë)




Figura 32: Shpeshtësia e përdorimit të internetit sipas gjinisë

### Shpeshtësia e përdorimit të internetit (sipas moshës)





Figura 33: Shpeshtësia e përdorimit të internetit (sipas moshës)

Diagrami më poshtë tregon se shumica e përdoruesve e shfrytëzojnë internetin gjatë tërë ditës, por më pak në mëngjes dhe vonë në mbrëmje.

### Gjatë cilës kohë të ditës e përdorni internetin?



**Figura 34: Përdorimi ditor i internetit**

Diagram në vijim na e jep një pasqyrë më të mirë. Është grupuar sipas moshës dhe nxjerr në pah informata interesante sa i përket gjeneratave më të reja (meqë është grupmosha më e madhe), të cilët nuk e përdorin internetin domosdo në mëngjes, porse janë më aktiv gjatë ditës dhe vonë në mbrëmje. Në anën tjetër, pjesëmarrësit në studim të cilët janë 50 vjeç ose më të moshuar janë aktiv në mëngjes dhe gjatë ditës, por jo vonë gjatë natës. Së fundmi, është me rëndësi të vërejmë se interneti është më pak i përdorur në Kosovë gjatë pasdites dhe menjëherë pas kryerjes së orarit të punës. Për ta lehtësuar leximin e diagramit më poshtë, 7.9% e pjesëmarrësve në studim të moshës 10-19 vjeçare e përdorin internetin në mëngjes, gjatë ditës 42.6% të kësaj grup moshe e përdorin internetin, gjatë pasdites 20.4% të kësaj moshe e përdorin internetin, dhe së fundmi gjatë mbrëmjeve dhe pas mesnatës 29.2% të grupmoshës 10-19 vjeçe e përdorin internetin.

## Përdorimi ditor i internetit sipas moshës




Figura 35: Përdorimi ditor i internetit sipas moshës

Krahasuar me përdoruesit e internetit përmes telefonave të mençur, ku shumica e përdoruesve e kalojnë 1-2 orë në ditë në internet, përdoruesit e kompjuterëve personal janë në internet deri në 3 orë në ditë. Vëreni se nuk ka informata nëse përdoruesit e telefonave të mençur mobil, krahas pranisë së tyre në internet me telefonat mobil, kalojnë edhe kohë tjetër në internet përmes kompjuterëve të tyre personal ose laptopëve.

### Sa orë në ditë i kaloni duke e shfletuar internetin?




Figura 36: Përdorimi i internetit - orë në ditë

Duket se përdoruesit kosovarë të internetit janë mjaft komunikues pasi 80% e tyre e përdorin internetin kryesisht për komunikim, ndërsa grupi i dytë më i madh është ai i cili e përdor internetin për argëtim.

### Për çfarë qëllimi e përdorni internetin?




Figura 37: Qëllimi i përdorimit të internetit

Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë, janë mesatarisht 5.85 anëtarë të një familje që jetojnë në një shtëpi. Nëse kjo krahasohet me diagramin më poshtë, del se mesatarisht së paku gjysmë anëtar i familjes është përdorues i internetit.



### Sa anëtarë të tjerë të familjes e përdorin internetin?




Figura 38: Përdormi i internetit nga anëtarët e familjes

## 7.4 GJUHA

Diagrami më poshtë ofron informata sa i përket gjuhës që e shfrytëzojnë përdoruesit gjersa e shfletojnë internetin. Vëreni se shumica e përdoruesve të rinj të internetit e përdorin gjuhën angleze si gjuhë parësore, ndërsa gjuha shqipe përdoret më së shumti nga grupmoshat 40-59 vjeçare.

### Gjuha e përdorur nga përdoruesit e internetit




Figura 39: Gjuha e përdorur nga përdoruesit e internetit

## Gjuha e përdorur për shfletim të internetit sipas grupmoshës




Figura 40: Gjuha e përdorur nga përdoruesit e internetit sipas moshës

Sa i përket përdorimit të gjuhës në internet sipas gjinisë, grupi i përdoruesve femra del si më fitimtar. Ato e përdorin shqipen dhe anglishten më shumë sesa gjinia e kundërt. Sa i përket gjuhës gjermane, është me rëndësi të theksohet se meshkujt e moshës 20-29 vjeç janë grupi më i madh i përdoruesve. Kjo mbase ka të bëjë me qendrat e ndryshme afariste të thirrjeve në gjuhën gjermane që veprojnë në Kosovë, dhe mbase të nevojave të tjera të komunikimit me diasporën shqiptare në Gjermani dhe Zvicër

## Gjuha e përdorur për shfletim të internetit sipas gjinisë




Figura 41: Gjuha e përdorur për shfletim të internetit (sipas gjinisë)

## 8. MOS-PËRDORUESIT E INTERNETIT

Më lart u cek se Kosova ka numër të lartë të përdoruesve të internetit dhe një shkallë të lartë të depërtimit të tij nëpër ekonominë familjare (që mund të krahasohet me vendet e zhvilluara). Kjo do të jetë një prej faktorëve kryesorë që do të ndikojnë në të ardhmen për një shkallë më të ngadalësuar të depërtimit të internetit. Rezultatet në diagramin më poshtë, ku 65% e atyre që nuk e përdorin internetin, nuk e kanë as në plan dhe nuk besojnë se së shpejti do ta përdorin atë, tregojnë se mbeten vetëm 35% të mos-përdoruesve të internetit, të cilët në të ardhmen mund të jenë përdorues të mundshëm. Ky fakt e mbështet përfundimin se Kosova do të ketë një ritje më të ngadalshme në të ardhmen sa i përket internetit, ngjashëm me vendet e zhvilluara.

### A mendoni se duhet të filloni ta përdorni internetin sa më parë?




Figura 42: Përdorimi i internetit në të ardhmen nga jo-përdoruesit

Raporti i vitit 2012 i Komisionit Evropian thekson se arsyeja më e shpeshtë e mospërdorimit të internetit është mungesa e interesit<sup>51</sup> dhe se kjo nuk ndryshon edhe në rastin e Kosovës. Arsyeja e dytë, ngjashëm si në Evropë, është mungesa e shkathtësive, dhe se diagrami më poshtë i tregon rezultatet e njëjta edhe për Kosovën. Vëreni se shifrat më poshtë nuk e arrijnë saktësisht 100% për shkak të përgjigjeve me shumë opsione në pyetësorin elektronik.

### Pse nuk e përdorni internetin?




Figura 43: Arsyet e mospërdorimit të internetit

51 [https://ec.europa.eu/digital-agenda/sites/digital-agenda/files/scoreboard\\_digital\\_skills.pdf](https://ec.europa.eu/digital-agenda/sites/digital-agenda/files/scoreboard_digital_skills.pdf)

## 9. SHFRYTËZIMI I INTERNETIT

### 9.1.1 ARGËTIM

Në përgjithësi interneti është përdorur më së shumti për argëtim. Ky aspekt nuk ndryshon as në rastin e Kosovës, veçanërisht në ditët e sotme ku përdoret edhe për shoqërim. Ka edhe shumë shërbime të tjera të cilat i ofron interneti, por që vetëm këto në vijim janë marrë në shqyrtim.

Duket qartë se shfrytëzimi i adresës elektronike (email), facebook-ut, Skype dhe Youtube janë shërbimet kryesore të cilat shfrytëzohen në Kosovë. Diagrami më poshtë i tregon shërbimet e shumta të internetit që janë të pavarura, prandaj variablat nuk bëjnë saktësisht 100% siç mund të pritet nga ndokush. 73.3% të përdoruesve të internetit i shfrytëzojnë shërbimet e facebook-ut. Kjo tregon se 73.3% prej 76.6% (të përdoruesve të internetit) janë përdorues të facebook-ut, që nënkupton se 43.6% (afërsisht 790,000) e popullsisë së përgjithshme të Kosovës e përdorin shërbimin e facebook-ut.

#### Çfarë shërbimesh i përdorni në internet?




Figura 44: Shërbimet e internetit që përdoren në Kosovë

Kur kemi të bëjmë me statusin e punësimit dhe përdorimin e shërbimeve të internetit është interesant të theksojmë se dallimet janë të papritura. Për shembull, siç paraqitet në diagramin më poshtë, Twitter përdoret më së shumti nga të papunësuarit (që sinjalizon kah gjeneratat e reja – shih diagramin tjetër), kurse shfrytëzimi për lexim, hulumtim dhe studim bëhet nga të punësuarit (që sinjalizon se shumica e të punësuar pjesëmarrës në këtë hulumtim mund të jenë duke studiuar apo kryer ndonjë aktivitet hulumtues). Siç pritej, përdorimi i emailit për punë dhe i LinkedIn bëhet prej të punësuarve pjesëmarrës në hulumtim, ndërsa lojërat në Facebook dhe Instagram janë shërbime që përdoren më së shpeshti nga të papunësuarit. Në fund, leximi i lajmeve parapëlqehet më së shumti prej qytetarëve të punësuar. Për ta ilustruar diagramin më poshtë, 93% e të punësuarve që janë përdorues të internetit e shfrytëzojnë emailin për punë, ndërsa vetëm 7% e të papunësuarve e përdorin emailin për punë. Ngjashëm me këtë, 54% e të punësuarve që e përdorin internetin kanë emaila personal, ndërsa 46% e të papunësuarve posedojnë emaila personal.

## Relationship between employment and Internet usage




Figura 45: Marrëdhëniet mes punësimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve të internetit

### 9.1.1.1 SPORTI

Siç paraqitet në diagramin më poshtë, kur kemi të bëjmë me çështje që lidhen me informata të sportit, meshkujt e moshës 13-19 vjeç dhe të rinjtë deri në moshën 29 vjeç e përbëjnë grupin më të madh të përdoruesve. Megjithatë ekziston një dallim i dukshëm kur kemi të bëjmë me gjininë, siç paraqitet në diagramin tjetër më poshtë.

#### Përdormi për sport (video dhe lajme) sipas moshës




Figura 46: Përdormi për sport (video dhe lajme) sipas moshës

#### Përdorimi për sport (video dhe lajme) sipas gjinisë




Figura 47: Përdorimi për sport (video dhe lajme) sipas gjinisë

### 9.1.1.2 LAJME

Grupmosha prej 20 deri 29 vjeç përbëjnë grupin më të interesuar në lajme, kurse nga pikëpamja gjinore, meshkujt janë shumicë në leximin e lajmeve. Ia vlen të përmendet se gjeneratat e reja janë më të interesuara në lajmet në internet kur bëjmë krahasim me gjeneratat më të vjetra siç paraqitet në diagramin më poshtë. Arsyeja për këtë mund të jetë se gjeneratat më të vjetra e shfrytëzojnë medien e shkruar dhe TV si burimin kryesorë të informatave, ndërsa gjeneratat më të reja varen më shumë në shërbimet e internetit.

#### Leximi i lajmeve, përdorimi sipas moshës




Figura 48: Përdorimi i internetit për lajme sipas moshës

#### Leximi i lajmeve, përdorimi sipas gjinisë




Figura 49: Përdorimi i internetit për lajme sipas gjinisë

### 9.1.1.3 MUZIKA DHE FILMAT

Në këtë seksion, shfrytëzimi i internetit për shkarkimin e filmave (file në torrent), dhe shikimin e filmave online janë përfshirë po ashtu në këtë hulumtim. Është interesant të analizohet më tej ky lloj i informatave pasi që të fillon të zbatohet ligji për të drejtën autoriale në Kosovë siç po diskutohet kohëve të fundit nëpër medime. Diagrami më poshtë tregon se aktivitetet kryesore për shikimin dhe shkarkimin e filmave zhvillohet prej meshkujve të moshës 13-19 vjeçare, të pasuar nga grupmosha 20 deri 39 vjeçe.

#### Shkarkimi i filmave dhe muzikës (me torrent) përdoruesit sipas moshës




Figura 50: Shkarkimi i filmave dhe muzikës (sipas moshës)

#### Shkarkimi i filmave dhe muzikës (me torrent) përdoruesit sipas gjinisë




Figura 51: Shkarkimi i filmave dhe muzikës (sipas gjinisë)



#### 9.1.1.4 SHFLETIMI I PËRGJITHSHËM I INTERNETIT

Diagrami më poshtë tregon se të rejat femra që e përdorin internetin qëndrojnë më përpara në krahasim me meshkujt për shfletimin e internetit dhe për lexim. Kjo është e vërtetë edhe kur kemi të bëjmë me përdorimin e internetit për hulumtim dhe studim, siç paraqitet në diagramin tjetër më poshtë.

##### Lexim për kureshtje (p.sh. Wikipedia, kërkim në Google), përdoruesit sipas moshës




Figura 52: Shfletim i përgjithshëm i internetit (sipas moshës)

##### Lexim për kureshtje (p.sh. Wikipedia, kërkim në Google), përdoruesit sipas gjinisë




Figura 53: Shfletim i përgjithshëm i internetit (sipas gjinisë)

### 9.1.1.5 INTERNETI, E-BANKING DHE BLERJA PËRMES INTERNETIT

Për shkak të mungesës së opsioneve të pagesës online dhe të shkallës së ulët të interesit, Kosova nuk ka lëvizur shumë përpara sa i përket shërbimeve me pagesë online në krahasim, për shembull, me depërtimin e internetit. Ka edhe arsyeje të tjera si mirëqenia e përgjithshme e qytetarëve, mungesa e bashkërendimit mes bankave vendore, por edhe shërbimet e dërgesave që janë shumë pak të zhvilluara si në aspektin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar. Pyetja më poshtë e përforcon faktin se shumica e pjesëmarrësve në hulumtim nuk besojnë në blerjen online përmes internetit, kurse në anën tjetër, grupi i dytë i përfaqëson përdoruesit që nuk kanë ndonjë problem me blerjet online. Siç mund të shihet, përdoruesit e internetit janë të ndarë thellë sa i përket kësaj çështje, dhe se rezultat i kësaj është mungesa e shërbimeve të pagesave online që mund ta ngrisin vetëdijen tek përdoruesit kosovarë të internetit. Siç mund të shihet pak më poshtë në diagramin e organizuar sipas moshës, gjeneratat më të vjetra thjeshtë nuk besojnë në këtë shërbim, ndërsa gjeneratat më të reja janë të ndarë sa i përket mendimeve të tyre nëse besojnë në blerjet online ose nëse duhet t'u shmangen atyre. Sido që të jetë, 44% e pjesëmarrësve do të ishin të lumtur të bënin blerje përmes internetit.

#### A do të blinit onlajn nëse produktet dhe shërbimet do të ishin në dispozicion për blerje përmes kartelës bankare?




Figura 54: Besimi në blerjen përmes internetit

## A do të blinit onlajn nëse produktet dhe shërbimet do të ishin në dispozicion për blerje përmes kartelës bankare?




Figura 55: Besimi në blerjen përmes internetit sipas moshës

### 9.1.2 KOMUNIKIMI ME ZË

Një prej motivuesve kryesorë të rritjes së kërkesës për internet është mënyra e lehtë e komunikimit të cilën e ofron interneti. Duke e pasur parasysh faktin se gati secili i tretë kosovarë jeton sot jashtë vendit, dhe secila ekonomi e tretë familjare në Kosovë e ka së paku një anëtarë të familjes që jeton jashtë vendit<sup>54</sup>, atëherë komunikimi me shpenzime sa më të ulëta ka rëndësi të veçantë, dhe se interneti e ofron mu këtë mundësi. Me një numër të lartë të përdoruesve të internetit dhe me pajisje të ndryshme si kompjuterë personalë, laptop-ë, tabletë dhe telefona të mençur, kosovarët janë dhe do të mbesin shfrytëzues seriozë të komunikimit me zë përmes internetit meqë kanë një numër të madh të anëtarëve të familjes që jetojnë jashtë vendit. Edhe në këtë rast, gjeneratat e reja janë grupi kryesor i përdoruesve që i shfrytëzon shërbimet VoIP të telefonave të mençur, siç mund të shihet më poshtë. Kur kemi të bëjmë me aspektin gjinor, femrat qëndrojnë pak më mirë në shfrytëzimin e aplikacioneve të telefonave të mençur si Viber, WhatsApp, dhe Tango.

54 [www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/ressources/resource\\_en\\_180366.pdf](http://www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/ressources/resource_en_180366.pdf), p.5

### Përdoruesit e Viber, WhatsApp dhe Tango sipas moshës




Figura 56: Përdorimi i internetit për komunikim me VoIP sipas moshës

### Përdoruesit e Viber, WhatsApp dhe Tango sipas gjinisë




Figura 57: Përdorimi i internetit për komunikim me VoIP sipas gjinisë

Shërbimi i Skype është një mjet shtesë i komunikimit me familjet kosovare që jetojnë jashtë vendit. Megjithatë, ky shërbim është i popullarizuar edhe në aspektin global për shkak të cilësisë së mirë të zërit dhe videos. Përveç kësaj, ky shërbim është i popullarizuar edhe në zonat rurale duke e pasur parasysh faktin e numrit të lartë të emigrantëve që vijnë prej këtyre zonave<sup>55</sup>. Sa i përket grupmoshës, Skype përdoret prej të gjitha grupmoshave deri në 49 vjeç, ku intensiteti fillon të bie.

### Përdoruesit e Skype sipas moshës




Figura 58: Përdorimi i internetit – shërbimi i Skype (sipas moshës)

Ngjashëm me aplikacionin VoIP të telefonave të mençur, edhe Skype, i cili po ashtu ekziston si aplikacion në këta telefona, përdoret pak më shumë prej gjinisë femërore.

### Përdoruesit e Skype sipas gjinisë




Figura 59: Përdorimi i internetit – shërbimet e Skype (sipas gjinisë)

## 9.1.3 RRJETET SOCIALE

Për qëllim të këtij studimi janë marrë parasysh edhe Twitter, Instagram dhe Facebook, për shkak se shërbimet e tjera të rrjeteve sociale, si LinkedIn dhe Xing janë më pak të popullarizuara në Kosovë (Xing është shumë i popullarizuar në vendet gjerman folëse, ku gjendet shumica e diasporës kosovare). Rezultatet janë paraqitur në diagramin më poshtë. Duket qartë se si përdoruesit meshkuj dhe femra janë aktivë në shfrytëzimin e këtyre shërbimeve. Në aspektin global, sipas raportit të Pew Research, Twitter përdoret pa dyshim prej të rinjve kosovarë të moshës 13-19 vjeç si dhe të atyre deri në moshën 29 vjeçare. Twitter përdoret më së shumti prej të rriturve të moshës 18-29 vjeç dhe banorëve të zonave urbane. Instagrami përdoret prej të rriturve të moshës 18-29 vjeç, grave, dhe banorëve të zonave urbane<sup>56</sup>.

### 9.1.3.1 TWITTER

Siç u cek më lartë, Twitter përdoret pa dyshim nga të tijnxherët Kosovarë dhe grupmoshat deri me 29 vjeç. Si me shërbimet e tjera të komunikimit dhe socializmit, femrat janë pak më përpara në shfrytëzimin e tyre. Është me rëndësi të theksohet se ky shërbim përdoret shpesh prej politikanëve dhe personave të famshëm në Kosovë.

#### Përdorimi i Twitter sipas moshës




Figura 60: Përdorimi i Twitter sipas moshës

### Përdorimi i Twitter sipas gjinisë




Figura 61: Përdorimi i Twitter sipas gjinisë

### 9.1.3.2 INSTAGRAMI

Në Kosovë, sikurse Twitter, ashtu edhe Instagrami përdoret më së shumti prej moshës 13-19 vjeçe. Ndërsa kur kemi të bëjmë me gjininë, përdorimi i tij është pothuaj i barabartë mes meshkujve dhe femrave.

### Përdorimi i Instagramit sipas moshës




Figura 62: Përdoruesit e Instagramit sipas moshës

### 9.1.3.3 FACEBOOK

Shfrytëzimi i Facebook-ut është paksa më i ndryshëm prej Twitter dhe Instagram. Facebook përdoret më shumë prej meshkujve dhe se është një prej katër aktiviteteve që parapëlqehen prej bashkësisë së përdoruesve kosovarë të internetit.

### Përdorimi i Facebook sipas moshës




Figura 63: Përdorimi i Facebook sipas moshës

### Përdorimi i Facebook sipas gjinisë




Figura 64: Përdoruesit e Facebook sipas gjinisë



### 9.1.3.4 YOUTUBE

Gjatë analizimit të dhënave të anketës lidhur me YouTube, duket qartë se femrat janë paksa më përpara në shfrytëzimin e tij në krahasim me meshkujt kur kemi të bëjmë me moshat e reja. Të dy grupet janë përdorues më të shpeshtë të YouTube gjatë moshës 13-19 vjeçe, si dhe në të njëzetat e tyre. Është me rëndësi të theksojmë se ka një rënie të shpejtë të përdorimit të tij kur përdoruesit i mbushin të tridhjetat, dhe pastaj kjo përsëritet kur arrijnë moshën e të pesëdhjetave.

#### Përdorimi i YouTube sipas moshës




Figura 65: Përdorimi i internetit – shërbimet e YouTube (sipas moshës)

#### Përdorimi i YouTube sipas gjinisë




Figura 66: Përdorimi i internetit – shërbimet e YouTube (sipas gjinisë)

## 9.1.4 KOMUNIKIMI ME EMAIL

Komunikimi me email për arsye personale shfrytëzohet më së shumti nga gjeneratat e reja si dhe nga të rriturit deri në moshën 40 vjeçare, dhe gati në mënyrë të barabartë si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat. Megjithatë, komunikimi për punë dhe biznes është më i shprehur tek meshkujt. Kjo mund të ofrojë një pikëpamje të re sa i përket dallimeve në karrierë në bazë të gjinisë dhe e cila duhet të hulumtohet më tutje nga ekspertë të kësaj fushe. Sa i përket moshës dhe komunikimit me email për punë, diagrami tjetër më poshtë tregon se grupmosha 30-39 vjeçe janë më aktive sesa grupet e tjera.

### Përdorimi i emailit personal sipas moshës




Figura 67: Përdorimi i emailit për çështje personale sipas moshës

### Përdorimi i emailit personal sipas gjinisë




Figura 68: Përdorimi i emailit për çështje personale sipas gjinisë

### Përdorimi i emailit për punë sipas moshës




Figura 69: Përdorimi i emailit për punë sipas moshës

### Përdorimi i emailit për punë sipas gjinisë




Figure 70: Përdorimi i emailit për punë sipas gjinisë

## 9.1.5 STILI I TË JETUARIT

Në krahasim me meshkujt, femrat janë më përpara në shfrytëzimin e internetit për mbledhjen e informatave sa i përket stilit të jetesës dhe të veshjes. Sa i përket moshës, grupmoshat prej 10-29 vjeçe janë më aktivet, por pastaj ka një rënie të shpejtë kur përdoruesit i arrijnë të tridhjetat. Pasi femrat janë grupi më i madh i përdoruesve, duket qartë se posa femrat t'i arrijnë të tridhjetat, për ndonjë arsye e humbin interesimin për të kërkuar ide për veshje dhe stil (kjo rënie është më shumë se 50%).

### Përdorimi për stil dhe veshje sipas moshës




Figura 71: Interneti dhe stili i të jetuarit (sipas moshës)

### Përdorimi për stil dhe veshje sipas gjinisë




Figura 72: Interneti dhe stili i të jetuarit (sipas gjinisë)

## 9.1.6 HULUMTIME DHE STUDIME

Ngjashëm me seksionin e komunikimit dhe të rrjeteve sociale më lartë, femrat e reja janë më aktive në përdorimin e internetit për hulumtime dhe studime. Grupmosha 20-29 u prijnë këtyre aktiviteteve, që është diçka e pritshme pasi këto përdorueset janë duke studiuar ose e ndjekur ndonjë trajnim. Paraqiten dy lloje të rënies së shpejtë posa përdorueset ta arrijnë moshën 30 vjeçare dhe pastaj 40 vjeçare, sikur të mos ketë nevojë për të mësuar më. Këto statistika mund të jenë me interes për ata që e promovojnë shkollimin ose aftësimin gjatë gjithë jetës.

### Për qëllim të hulumtimit dhe studimeve, përdorues sipas moshës




Figura 73: Shfrytëzimi i internetit për hulumtime dhe studime (sipas moshës)

### Për qëllim të hulumtimit dhe studimeve, përdorues sipas gjinisë




Figura 74: Shfrytëzimi i internetit për hulumtime dhe studime (sipas gjinisë)

## 10. VETËDIJA PËR e-QEVERISJE

Diagrami më poshtë e tregon nivelin e vetëdijes së popullsisë sa i përket shërbimeve të ofruara nga qeveria e Kosovës përmes shfrytëzimit të internetit. Pak më pak se gjysma e pjesëmarrësve në studim janë të vetëdijshëm për këto shërbime. Kjo vetëdije e arrin pikën më të lartë te grupmosha 20-29 vjeçe, ndërsa për përdoruesit më të moshuar ky trend fillon të bie ngadalë. Siç shihet, femrat janë më pak të vetëdijshme për këtë shërbim në krahasim me meshkujt.

**A jeni të informuar kur aplikoni për dokumente zyrtare (letërnjoftim, pasaportë, patentë shoferi) se mund ta kontrolloni statusin e aplikacionit në internet?**




Figure 75: Shërbimet e e-qeverisjes

**A jeni të informuar kur aplikoni për dokumente zyrtare (letërnjoftim, pasaportë, patentë shoferi) se mund ta kontrolloni statusin e aplikacionit në internet?**




Figura 76: Shërbimet e e-qeverisjes sipas gjinisë

A jeni të informuar kur aplikoni për dokumente zyrtare (letërnjoftim, pasaportë, patentë shoferi) se mund ta kontrolloni statusin e aplikacionit në internet?




Figura 77: Shërbimet e e-qeverisjes sipas moshës

## 11. PRIVATËSIA E INFORMATAVE

Privatësia e informatave, posaçërisht në internet, mbetet një prej temave më interesante që është zhvilluara. Kjo temë është diskutuar prej aspekteve nga më të ndryshmet, përfshirë edhe nga ai demografik. Sipas diagramit më poshtë, duket qartë se fermat janë më të kujdesshme kur kemi të bëjmë me çështjen e privatësisë, dhe se kjo përkon edhe me të dhënat e mbledhura në nivel global<sup>57</sup>. Sa i përket moshës, të gjitha moshat deri 59 vjeç e kanë një farë niveli të vetëdijes sa i përket privatësisë, që përsëri është i ngjashëm me trendet botërore. Gjeneratat më të vjetra janë më pak të vetëdijshme sa i përket kësaj çështje. Megjithatë 19% e përdoruesve të moshës 10-19 vjeçare nuk janë po ashtu të vetëdijshëm sa i përket privatësisë së informatave. Në anën tjetër, përdoruesit e moshës 10-19 vjeçare janë gjithashtu grupi më i madh që di për privatësinë, por që nuk janë shumë të shqetësuar për të.

57 [www.pewinternet.org/Reports/2012/Privacy-management-on-social-media/Summary-of-findings.aspx](http://www.pewinternet.org/Reports/2012/Privacy-management-on-social-media/Summary-of-findings.aspx)

## Sa jeni të informuar për privatësinë e internetit?




Figura 78: Vetëdijesimi për privatësinë e informatave

## Vetëdijesimi për privatësinë e internetit sipas gjinisë




Figura 79: Vetëdijesimi për privatësinë e informatave (sipas gjinisë)



## Vetëdijesimi për privatësinë e internetit sipas moshës




Figura 80: Vetëdijesimi për privatësinë e informatave sipas moshës

## 12. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë është i krahasueshëm me vendet e zhvilluara. Ekzistojnë shumë faktorë që kontribuojnë në këtë nivel të lartë të përdorimit, ku disa prej tyre lidhen me moshën e re mesatare të kosovarëve (27.4)<sup>58</sup>, pastaj shumë familje i kanë të afërmit që jetojnë jashtë vendit (diaspora), kultura e përgjithshme, orientimi politik i vendit (vlerat perëndimore), pozita gjeografike e Kosovës, etj. Ekziston një korrelacion i dëshmuar mes shkollimit, të ardhurave dhe depërtimit të internetit<sup>59</sup>, por kjo nuk vlen për Kosovën për shkak të arsyeve të diskutuara më sipër. Marrëdhëniet midis nivelit të lartë të depërtimit të internetit dhe shifrave të varfërisë në Kosovë (12.1%)<sup>60</sup> mund të shpjegohen në dy mënyra. E para, ka të bëjë me Kosovën si rast i veçantë që mund të ndodh<sup>61</sup> për shkak të arsyeve të cekura më lartë; dhe arsyeja tjetër lidhet me analizën e mësipërme të këtij raporti ku pjesëmarrësit në studim janë shprehur që të ardhurat e familjes nuk janë një prej arsyeve kryesore për mospërdorimin e internetit. Në fakt, të ardhurat e familjes/personale janë ndër arsyet më të rralla të zgjedhur nga mos-përdoruesit e internetit të përmendur më lartë.

58 <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/fields/2177.html>

59 [http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2145704](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2145704)

60 <http://esk.rks-gov.net/eng/>

61 <http://arcusadvisors.com/new-markets-for-content-infrastructure/ict-and-poverty-2/>

Duket qartë se duhet të bëhet më shumë sa i përket nismave dhe bashkërendimit të sektorit të TIK-ut në Kosovë me synim të ofrimit të një vlere më të mirë për parat e shpenzuara nga përdoruesit. Sa i përket shkallës së lartë të depërtimit të internetit, palët kryesore të interesit duhet ta kenë parasysh mundësinë për punësim të rinjve, që janë shumicë, aktivë dhe të aftë ta shfrytëzojnë internetin dhe mjetet e komunikimit me efikasitet tejet të lartë. Sektori i TIK-ut ka nevojë për një bashkëpunim më të madh sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe të shkëmbimit të informatave mes palëve të ndryshme të interesit, si dhe të përcaktimit të një plani të përbashkët të veprimit nga perspektiva e gjithëpërfshirjes dhe fuqizimit të rinjve.

Pritet që do të ketë një ngadalësim në të ardhmen sa i përket shkallës së depërtimit të internetit në nivel vendi. Kjo pritet të ndodh për dy arsye. E para ka të bëjë me shkallën e lartë aktuale të depërtimit të tij dhe mungesës së klientëve të mundshëm për zgjerimin e tregut, dhe se arsyeja e dytë, e paraqitur më lartë në këtë raport, ka të bëjë me 65% e mos-përdoruesve që theksojnë se nuk e kanë ndër mend ta përdorin internetin në një të ardhme të afërt.

Sipas të gjeturave të këtij studimi, pjesa më e madhe e shprehive të përdoruesve është e ngjashme me trendet globale. Shërbimet e rrjeteve sociale dhe të komunikimit me zë përmes internetit përdoren më së shumti nga femrat, dhe se ky është gjithashtu një trend global. Ngjashëm, lajmet që kanë të bëjnë me sportin lexohen dhe shikohen nga përdoruesit meshkuj të internetit, që është një trend po ashtu i ngjashëm në shkallë bote.

Meqë Kosova synon në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare në fushën e TIK-ut, atëherë duhet të mblidhen dhe përpunohen të dhëna përkatëse nga palët përgjegjëse të interesit. D.m.th., ofrimi i informatave si shkalla maksimale e kërkesës që është një parametër i rëndësishëm për cilësinë e shërbimeve. Pastaj, është e domosdoshme për agjendën politike të Kosovës të fillojë menjëherë me hartimin e treguesve të TIK-ut që mund të maten në mënyrë rregullt dhe t'i paraqiten publikut të përgjithshëm si dhe palëve të interesuara<sup>62</sup>.

Është diskutuar gjerë e gjatë se ka nevojë të merren iniciativa nga shumë drejtime, si hartimi dhe zhvillimi i mëtejme i legjislacionit dhe rregulloreve të përshtatshme me ato të BE-së për sektorin e TIK-ut, planet zhvillimore të sektorit, zbatim i një varg strategjish për TIK-un, trajtimi i problemeve aktuale lidhur me ccTLD dhe kodet ISO për Kosovën, pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me TIK-un, etj. Andaj, sugjerohet që institucionet e Kosovës ta kenë parasysh themelimin e Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit, ngjashëm me atë çfarë kanë bërë vendet fqinje (Maqedonia<sup>63</sup> dhe Mali i Zi<sup>64</sup>). Maqedonia i ka hartuar dy dokumente kombëtare strategjike, të cilat janë në dispozicion publik<sup>65 66</sup> (në maqedonisht), kurse Mali i Zi e ka publikuar listën e disa dokumenteve të cilat janë specifike në temë<sup>67</sup> të ndryshme, si rimëkëmbja pas ndonjë katastrofe, platformat e hapura, komunikimi digjital, etj. (në gjuhën e malaziasë).

Po ashtu rekomandohet që palët përkatëse të interesit ta ngritin vetëdijen e popullsisë sa i përket sigurisë në internet, transaksioneve financiare përmes internetit (pagesat online), kontrollin prindëror, privatësinë e informatave, etj.

Në fund, ky studim synonte në ofrimin e informatave të reja krahas atyre në raportet paraprake. Raporti ofron informata të vlefshme që lidhen me trendet, qëndrimet dhe shprehitë. Ky studim po ashtu kishte për synim që ta fillonte një diskutim sa i përket depërtimit të internetit, përdorimit dhe bashkëpunimit mes palëve përkatëse të interesit.

62 [http://www.unescap.org/idd/pubs/st\\_escap\\_2353.pdf](http://www.unescap.org/idd/pubs/st_escap_2353.pdf)

63 <http://www.mio.gov.mk>

64 <http://www.mid.gov.me>

65 [http://www.mio.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Strategija\\_i\\_Akcionen\\_Plan.pdf](http://www.mio.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Strategija_i_Akcionen_Plan.pdf)

66 [www.mio.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Nacionalna\\_strategija\\_zarazvoj\\_na\\_elektronski\\_komunikacij\\_so\\_informaticki\\_tehnologii.pdf](http://www.mio.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Nacionalna_strategija_zarazvoj_na_elektronski_komunikacij_so_informaticki_tehnologii.pdf)

67 <http://www.mid.gov.me/biblioteka/strategije>

## 13. REFERENCAT


(të renditura sipas alfabetit në bazë të titullit të dokumentit)


1. Telecom Regulatory Authority of India  
Annual Report, 2009  
[http://www.trai.gov.in/WriteReadData/UserFiles/Documents/AnnualReports/ar\\_08\\_09.pdf](http://www.trai.gov.in/WriteReadData/UserFiles/Documents/AnnualReports/ar_08_09.pdf)
2. Telecom Regulatory Authority of India  
Bandwidth required for ISPs for better connectivity and improved quality of service, 2009  
<http://www.trai.gov.in/WriteReaddata/ConsultationPaper/Document/cpaper15jan09.pdf>
3. Broadband Watchdog  
Broadband Guide, 2013  
<http://www.broadbandwatchdog.co.uk/contention.php>
4. Swiss Cooperation Office in Kosovo  
Diaspora as a driving force for development in Kosovo: myth or reality?, 2009  
[www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/ressources/resource\\_en\\_180366.pdf](http://www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/ressources/resource_en_180366.pdf)
5. European Commission  
Digital Competences in the Digital Agenda, 2012  
[https://ec.europa.eu/digital-agenda/sites/digital-agenda/files/scoreboard\\_digital\\_skills.pdf](https://ec.europa.eu/digital-agenda/sites/digital-agenda/files/scoreboard_digital_skills.pdf)
6. Kosovo Agency of Statistics  
Dwellings, Households and Population by Municipality, 2011  
<http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,40,265>
7. European Commission  
E-Communications Household Survey, 2011  
[http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/ebs/ebs\\_362\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/ebs/ebs_362_en.pdf)
8. LIRNEasia  
Estimating Internet Users: An Evidence-Based Alternative in the Absence of Survey Data, 2012  
[http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2145704](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2145704)
9. The Market Research Society  
Guidelines for Questionnaire Design, 2011  
<https://www.mrs.org.uk/pdf/2011-07-27%20Questionnaire%20Design%20Guidelines.pdf>
10. Index Kosova  
Home Page, 2009  
<http://www.indexkosova.com>
11. Kosovo Agency of Statistics  
Home Page, 2013  
<http://esk.rks-gov.net/eng/>
12. International Telecommunication Union  
ICT Facts and Figures, 2011  
<http://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures2013.pdf>

13. eSEEurope Initiative  
ICT Sector Status Report, 2004  
[www.stabilitypact.org/e-see/040906-ict-status.pdf](http://www.stabilitypact.org/e-see/040906-ict-status.pdf)
14. Miniwatts Marketing Group  
Internet and Search Engine Usage By Country, 2010  
[http://ptgmedia.pearsoncmg.com/images/9780789747884/supplements/9780789747884\\_appC.pdf](http://ptgmedia.pearsoncmg.com/images/9780789747884/supplements/9780789747884_appC.pdf)
15. Miniwatts Marketing Group  
Internet and Search Engine Usage By Country, 2010  
<http://www.internetworldstats.com/af/ke.htm>
16. Orkii Statistics and Indicators  
Internet Penetration Albania, 2011  
<http://www.orkii.com/albania/internet-penetration>
17. The Kosovo Association of Information and Communication Technology  
Internet Penetration and Usage in Kosovo, 2011  
[http://www.stikk-ks.org/images/stories/publikime/STIKK-raport\\_eng\\_email.pdf](http://www.stikk-ks.org/images/stories/publikime/STIKK-raport_eng_email.pdf)
18. Orkii Statistics and Indicators  
Internet Penetration Bulgaria, 2011  
<http://www.orkii.com/bulgaria/internet-penetration>
19. Orkii Statistics and Indicators  
Internet Penetration Macedonia, 2011  
<http://www.orkii.com/macedonia/internet-penetration>
20. Miniwatts Marketing Group  
Internet World Stats, 2008  
<http://www.Internetworldstats.com/europa2.htm#kv>
21. Kosovo Ministry of Trade and Industry  
Investing in Kosovo 2009, 2009  
[www.eciks.org/english/publications/investing\\_in\\_kosovo/content/media/investorsguide\\_web.pdf](http://www.eciks.org/english/publications/investing_in_kosovo/content/media/investorsguide_web.pdf)
22. Kosovo Ministry of Trade and Industry  
Investing in Kosovo 2010, 2010  
[http://ambasada-ks.net/us/repository/docs/Attach\\_1.\\_Investing\\_in\\_Kosovo\\_2010.pdf](http://ambasada-ks.net/us/repository/docs/Attach_1._Investing_in_Kosovo_2010.pdf)
23. Kosovo Agency of Statistics  
Kosovo Census 2011 Questionnaire, 2011  
<http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/R2ENG.pdf>
24. Kosovo Agency of Statistics  
Kosovo Population and Housing Census 2011, 2011  
[http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results\\_ENG.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Final%20Results_ENG.pdf)
25. United Nations Development Programme  
Kosovo Mosaic, 2012  
[www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/ourwork/povertyreduction/successstories/how-to-become-a-driving-force--kosovo-diaspora/](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/ourwork/povertyreduction/successstories/how-to-become-a-driving-force--kosovo-diaspora/)

26. European Commission  
Kosovo Progress Report 2009, 2009  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/ks\\_rapport\\_2009\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf)
27. European Commission  
Kosovo Progress Report 2010, 2010  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)
28. Google Maps  
Kosovo Wifi Map, 2013  
<http://goo.gl/shHUF>
29. Kuvendi i Kosoves  
Law on Copyright and Related Rights, 2004  
[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004\\_45\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_45_en.pdf)
30. University of Prishtina  
National Background Report on ICT Research for Kosovo , 2009  
[www.wbc-inco.net/attach/KosovoICTReportFINAL\\_01\\_12\\_2009.pdf](http://www.wbc-inco.net/attach/KosovoICTReportFINAL_01_12_2009.pdf)
31. New Zealand Ministry of Economic Development  
National Broadband Map, 2013  
<http://www.broadbandmap.govt.nz>
32. Autoriteti Rregullativ per Komunikime Elektronike dhe Postare  
Pasqyra e Tregut te Komunikimeve elektronike (Albanian), 2013  
[www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4\\_2012.pdf](http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf)
33. Autoriteti Rregullativ per Komunikime Elektronike dhe Postare  
Pasqyra e Tregut te Komunikimeve elektronike (Albanian), 2012  
[www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4\\_2012.pdf](http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf)
34. Pew Research Center  
Privacy Management on Social Media, 2012  
[www.pewinternet.org/Reports/2012/Privacy-management-on-social-media/Summary-of-findings.aspx](http://www.pewinternet.org/Reports/2012/Privacy-management-on-social-media/Summary-of-findings.aspx)
35. Autoriteti Rregullativ per Komunikime Elektronike dhe Postare  
Pyetesori per sherbimet e Internetit (ISP) (Albanian), 2010  
[http://art-ks.org/repository/docs/Pyetesori%20per%20Sherbimet%20e%20Internetit\\_\(ISP\).xls](http://art-ks.org/repository/docs/Pyetesori%20per%20Sherbimet%20e%20Internetit_(ISP).xls)
36. Autoriteti Rregullativ per Komunikime Elektronike dhe Postare  
Raportet Tremujore, 2013  
<http://www.art-ks.org/?cid=1,162/>
37. UN Economic and Social Commission for Asia and the Pacific  
Regulations, Policies and Legal Frameworks Related to ICT: International Management Standards for ICT Development in the Greater Mekong Sub-region, 2005  
[http://www.unescap.org/idd/pubs/st\\_escap\\_2353.pdf](http://www.unescap.org/idd/pubs/st_escap_2353.pdf)

38. Arcus Advisors  
Relation between Internet penetration in 2009 and poverty rates in 2005, 2009  
<http://arcusadvisors.com/new-markets-for-content-infrastructure/ict-and-poverty-2/>
39. Body of European Regulators for Electronic Communications  
Relevant market definition for business services, 2010  
[http://berec.europa.eu/doc/berec/bor\\_10\\_46.pdf](http://berec.europa.eu/doc/berec/bor_10_46.pdf)
40. RIPE NCC  
RIPE NCC Search Database, 2013  
<https://apps.db.ripe.net/search/full-text.html>
41. MaCorr Research  
Sample Size Methodology, 2013  
<http://www.macorr.com/sample-size-methodology.htm>
42. The Kosovo Association of Information and Communication Technology  
Skills Gap Analysis for Information and Communication Technology, 2011  
[www.stikk-ks.org/images/stories/publikime/Skills%20Gap%20Analysis%20for%20Information%20and%20Communication%20Technology.pdf](http://www.stikk-ks.org/images/stories/publikime/Skills%20Gap%20Analysis%20for%20Information%20and%20Communication%20Technology.pdf)
43. Pew Research Center  
Social Media Users, 2013  
[http://pewinternet.org/~media/Files/Reports/2013/PIP\\_SocialMediaUsers.pdf](http://pewinternet.org/~media/Files/Reports/2013/PIP_SocialMediaUsers.pdf)
44. Cullen International  
Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries, 2011  
<http://www.cullen-international.com/ressource/224/0/final-study-report-31-march-2011.pdf>
45. Cullen International  
Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries, 2013  
<http://www.cullen-international.com/ressource/5127/0/report-3-april-2013-final.pdf>
46. Delft University of Technology  
The Bittorrent P2P File-sharing System: Measurements and Analysis, 2004  
<http://www.cs.unibo.it/babaoglu/courses/cas04-05/papers/bittorrent.pdf>
47. Cochin University  
Wardriving, 2011  
<http://dspace.cusat.ac.in/jspui/handle/123456789/2362>
48. Daily Mail UK  
We now spend more time looking at our phone than with our partner, 2013  
<http://www.dailymail.co.uk/sciencetech/article-2333261/We-spend-MORE-time-phones-partner.html>
49. Central Intelligence Agency  
World Fact Book, 2013  
<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/fields/2177.html>








# INTERNET PENETRATION AND USAGE IN KOSOVO 2013


## INTERNET USER PENETRATION



## HOUSEHOLDS WITH INTERNET CONNECTIVITY IN URBAN AND RURAL AREAS



## INTERNET USERS BY GENDER




## INTERNET USERS BASED ON RURAL AND URBAN AREAS



## WHO USES THE INTERNET IN KOSOVO AND HOW DO THEY USE IT


### INTERNET USERS BY AGE




### INTERNET USERS BASED ON EDUCATION LEVEL



### WHAT SERVICES DO YOU USE ON THE INTERNET




### INTERNET USAGE LOCATION



### INTERNET ACCESS FROM MOBILE PHONES




### EMPLOYMENT STATUS OF THE MOBILE INTERNET USERS



## KOSOVO MIRRORS EUROPEAN NEIGHBORS ON USAGE

### INTERNET USERS BY GENDER



THE REPORT CHANNELS THE VOICES OF  
1050 KOSOVANS FROM 30 MUNICIPALITIES




Ministria e Punëve të Jashtme  
Ministry of Foreign Affairs




WWW.STIKK-KS.ORG

### FREQUENCY OF INTERNET USAGE



### FREQUENCY OF INTERNET USAGE BY GENDER





Rexhep Mala str. 28 A,  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel. +381 38 77 11 80 ext. 501  
[info@stikk-ks.org](mailto:info@stikk-ks.org), [www.stikk-ks.org](http://www.stikk-ks.org)



*Ministria e Punëve të Jashtme*  
*Ministry of Foreign Affairs*



NORWEGIAN MINISTRY  
OF FOREIGN AFFAIRS

